



Shënim: Seance Plene



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2025

Lënda: Depozitim projektligji

SH.T.ZNJ. ELISA SPIROPALI  
KRYETARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
Këtu

E nderuar znj, Kryetare,

Mbështetur në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ju paraqes projekt-ligjin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Hëjra dhe Dezinformimit 2025-2030”

DEPUTETËT PROPOZUES

1. ERION BRAÇE

2. ETILDA GJONAJ

3. BLENDAR ÇUÇI

4. MIMI KODHELI

5. PANDELI MAJKO

6. ENSLEMVERA ZAKE

7. BARDHËYL KOLLÇAKU

8. ALBAN XHELILI

**PROJEKTLIGJ**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2025

**PËR**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR NDËRHYRJEVE TË  
HUAJA DHE DEZINFORMIMIT**

**2025-2030**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të deputetëve,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:  
VENDOSI:**

**Neni 1**

Miratimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit, 2025-2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYETAR**

**ELISA SPIROPALI**

## **RELACION SHOQËRUES I PROJEKTLIGJIT**

### **“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR NDËRHRYJEVE TË HUAJA DHE DEZINFORMIMIT 2025-2030”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhryjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025-2030.

Ndërhryjet e huaja dhe dezinformimi janë kërcënime që sfidojnë sigurinë kombëtare, stabilitetin politik dhe zhvillimin demokratik të Republikës së Shqipërisë. Në një kontekst global ku aktorë të ndryshëm përdorin instrumente hibride për të ndikuar në vendimmarrjen politike, ekonominë, mediat dhe opinionin publik, është e domosdoshme që shteti shqiptar të ketë një strategji të qartë për të parandaluar dhe kundërshtuar këto kërcënime.

Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhryjeve të Huaja dhe Dezinformimit përfaqëson një angazhim të qartë të Shqipërisë për të mbrojtur demokracinë, sovranitetin dhe rendin kushtetues përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, të bazuar në koordinimin ndërinstucional dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Kjo strategji synon të ndërtojë qëndrueshmërinë e shoqërisë dhe të institucioneve ndaj ndërhryjeve të huaja, të rrisë ndërgjegjësimin dhe të forcojë kapacitetet për parandalimin dhe reagimin ndaj tyre.

Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare Kundër Ndërhryjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025-2030 është të forcojë mekanizmat e mbrojtjes ndaj veprimeve keqdashëse të aktorëve të huaj që cenojnë sigurinë dhe stabilitetin e vendit. Kjo strategji synon:

- Mbrojtjen e institucioneve demokratike nga ndërhryjet e huaja në vendimmarrje.
- Garantimin e integritetit të proceseve zgjedhore, duke parandaluar ndërhryjet e huaja në financimin e partive politike, fushatat elektorale dhe informimin e publikut.
- Forcimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë kundër dezinformimit, përmes edukimit mediatic dhe transparencës së informacionit.
- Rritjen e kapaciteteve shtetërore dhe institucionale për të zbuluar, analizuar dhe adresuar ndërhryjet e huaja dhe dezinformimin.
- Koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar me aleatët strategjikë dhe institucionet euroatlantike për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të forcuar mekanizmat mbrojtës.

Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse, përfshirë dezinformimin, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare, me synimin për të përballuar sfidat e tashme dhe të ardhshme në një mjedis gjeostrategjik kompleks. Kjo strategji, me theks në mbrojtjen e interesave kombëtare dhe strategjike, synon të krijojë një front të koordinuar dhe efektiv kundër ndërhyrjeve të huaja, që kanë si qëllim cënimin e sigurisë së brendshme, dobësimin e institucioneve demokratike, destabilizimin, manipulimin e opinionit publik dhe cënimin e proceseve zgjedhore, duke përdorur instrumente politik, diplomatik, ushtarak, ekonomik, financiar, ligjor dhe të shërbimeve inteligjente.

Përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, strategjia ka objektiv të parandalojë dhe minimizojë ndikimet negative të ndërhyrjeve, duke rikthyer funksionalitetin e plotë në rast dëmtimi, si dhe të sigurojë një reagim të shpejtë dhe të koordinuar, në përputhje me standardet europiane. Strategjia synon të ruajë stabilitetin politik, integritetin e proceseve zgjedhore dhe funksionimin e infrastrukturës kritike, duke promovuar një ambient informativ të hapur, transparent dhe profesional, i cili mbështetet në vlerat universale të drejtave të njeriut dhe lirisë së shprehjes.

Në këtë kontekst, ndërhyrjet e huaja, të cilat realizohen në mënyra të hapura dhe të fshehta, nga aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë, synojnë të zhbëjnë kufijtë mes paqes, krizës dhe konfliktit, duke krijuar situata të pidentifikueshme dhe komplekse që paralizojnë procesin e vendimmarrjes politike dhe cënojnë besimin në mekanizmat garantues të rendit kushtetues, ndërkohë që ndikojnë edhe në sektorët ekonomikë dhe financiarë përmes manipulimit të burimeve dhe investimeve strategjike. Për Shqipërinë, kjo sfidë është veçanërisht e mprehtë duke qenë një vend me orientim euro-atlantik, anëtar i NATO-s dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ku stabiliteti i sigurisë kombëtare lidhet ngushtë me zhvillimet ndërkombëtare dhe angazhimet për forcimin e institucioneve demokratike.

Strategjia gjithashtu synon të shfrytëzojë elementët unifikues të identitetit kombëtar, historisë së përbashkët dhe orientimit euroatlantik, të cilat përfaqësojnë një faktor përbashkues për mbrojtjen kundër ndërhyrjeve keqdashëse, përmes promovimit të kulturës, traditave dhe kontributit të diasporës shqiptare në arenën ndërkombëtare, duke krijuar kështu një mjedis informativ më rezistent ndaj manipulimit.

Për të adresuar këto sfida, strategjia përcakton mekanizmat kryesorë për forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e vigjilencës dhe koordinimin ndërinstitucional, duke ngritur struktura të dedikuara që mbikëqyrin dhe analizojnë veprimtaritë e lidhura me kërcënimet hibride dhe dezinformimin, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e standardeve europiane. Në fund, kjo strategji aktive veprimi jo vetëm përcakton interesat, objektivat dhe prioritetet e vendit në kontekstin e sigurisë kombëtare dhe demokratike, por gjithashtu vendos themelet për një reagim të

integruar dhe të vazhdueshëm, që do të kontribuojë në garantimin e rendit kushtetues, transparencës, integritetit të informacionit etj., duke siguruar që informacioni i shpejtë dhe i saktë të shërbejë si bazë për vendimmarrjen e duhur dhe për neutralizimin e ndikimeve të huaja keqdashëse.

Në dekadat e fundit, sfera e informacionit digjital është shndërruar në një hapësirë publike të rëndësishme për diskutim dhe shkëmbim idesh, ku individët mund të marrin informacion, formojnë mendime dhe shprehin pikëpamjet e tyre. Sidoqoftë, në dekadën e fundit, ekosistemet globale të informacionit janë bërë gjithashtu një arenë e fortë e rivaliteteve gjeostrategjike. Aktorët shtetërorë autoritarë kanë intensifikuar përdorimin e teknologjive për manipulimin e opinionit publik dhe krijimin e ndasisë dhe tensioneve.

Në këtë kontekst, rëndësia strategjike dhe presionet sistematike mbi mjedisin e informacionit të hapur, pritet të shtohen, duke e bërë edhe më të domosdoshëm angazhimin për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave universale në këtë hapësirë digjitale, vlera si të drejtat e njeriut dhe, në mënyrë të veçantë, liria e shprehjes.

Për Shqipërinë, kjo çështje është veçanërisht e ndjeshme, duke pasur parasysh interesin kombëtar dhe konsolidimin e faktorit shqiptar në rajon; kontekstin e procesit të integritetit evropian dhe përpjekjet për forcimin e institucioneve demokratike në vend.

Një nga objektivat kryesore të strategjisë është sigurimi i integritetit të proceseve zgjedhore, përfshirë parandalimin e ndërhyrjes së huaj keqdashëse, në financimin e partive politike e fushatave elektorale. Përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe zhvillimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, strategjia synon të ofrojë një reagim të shpejtë dhe të koordinuar ndaj çdo përpjekjeje për ndërhyrje të huaja, duke mbrojtur kështu rendin demokratik dhe besimin e publikut.

Në aspektin e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, strategjia nxit bashkëpunimin ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, duke përfshirë partneritetet me aleatët strategjikë si NATO, Bashkimi Evropian, OSBE dhe institucionet e tjera relevante, në shkëmbimin e informacionit, harmonizimin e praktikave dhe përmirësimin e standardeve ligjore dhe teknologjike për të përballuar sulmet kibernetike dhe fushatat e dezinformimit.

Përmes kësaj strategjie, synohet të forcohet qëndrueshmëria e shoqërisë shqiptare, duke promovuar transparencën, edukimin mediatik dhe ndërgjegjësimin publik. Këto masa do të ndihmojnë në krijimin e një ambienti informativ të hapur, të bazuar në verifikimin e fakteve dhe lirinë e shprehjes, duke mbrojtur kështu të drejtat e liritë themelore të qytetarëve.

Ky projektligj përmirëson kuadrin e mbrojtjes së interesave kombëtare duke vendosur një strategji të integruar dhe gjithëpërfshirëse, duke synuar një hap të rëndësishëm drejt mbrojtjes së demokracisë dhe sigurimit të një të ardhme të qëndrueshme për vendin.

## II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME SYNIMET E STRATEGJISË

Projektakti është hartuar në përputhje me objektivat e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”, ngritur me Vendimin e Kuvendit nr. 40/2024, duke synuar forcimin e qëndrueshmërisë institucionale, mbrojtjen e proceseve demokratike, mbrojtjen e ekonomisë kombëtare e infrastrukturës kritike, si dhe mbrojtjen e promovimin e lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe pluralizmin online dhe offline, aksesit në informacion, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe nxitjen e debatit publik rreth angazhimit kundër dezinformimit.

Dokumenti mbështetet në praktikën dhe masat e zbatuara brenda Bashkimit Evropian, në raportet dhe rekomandimet e BE-së për Shqipërinë lidhur me kërcënimet hibride, si dhe në përvojën e vendeve demokratike në adresimin e këtyre sfidave. Kjo qasje siguron harmonizimin e politikave kombëtare me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, duke rritur kapacitetin e shtetit për të identifikuar, parandaluar dhe kundërshtuar fushatat e dezinformimit dhe ndikimet e huaja keqdashëse.

Gjithashtu, Memorandumi i Mirëkuptimit SHBA-Shqipëri “Për përgjigjen kundër manipulimeve të informacionit nga shtetet e huaja”, nënshkruar më 15 shkurt 2024, në Tiranë, Shqipëria si palë në marrëveshje, ka detyrimin e angazhohet të ndërtojë një kuadër ligjor kundër manipulimit të informacionit të huaj, për:

- Trajtimin efektiv të manipulimit të informacionit të huaj, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e strategjive kundër këtij kërcënimi;
- Krijimin dhe administrimin e një qasjeje kombëtare të koordinuar, ndër-institucionale;
- Disponimin e kapaciteteve teknike dhe ndërgjegjësimin e rritjen e kapaciteteve njerëzore të nevojshme dhe efektive;
- Përfshirjen e shoqërisë civile, medias dhe botës akademike, si entitete me rol thelbësorë, për të mbështetur dhe kontribuar në nismat qeverisëse të ndërmarra kundër manipulimit të informacionit të huaj.

### **Konstatime dhe problematika të dala nga seancat dëgjimore me institucionet publike:**

- **Dezinformimi dhe ndikimi i huaj:** Dezinformimi brenda vendit shpesh ka origjinën nga burime jashtë, duke theksuar ndikimin e motorëve të propagandës ndërkombëtare. Ky fenomen rrezikon besimin publik dhe destabilizon proceset demokratike, duke i dhënë mundësi ndërhyrjes së huaj në çështje të brendshme. Për këtë, është e nevojshme ngritja e strukturave të specializuara për analizën dhe

menaxhimin e dezinformimit, si dhe bashkëpunimi i brendshëm ndërinstitucional, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, për të garantuar sigurinë kombëtare.

- **Mungesa e teknologjisë dhe përmirësimi i mbrojtjes kibernetike:** Institucionet që janë objekt i sulmeve kibernetike vuajnë nga një mungesë e konsiderueshme e kapaciteteve teknologjike, duke vështirësuar mbrojtjen e sistemeve. Kjo kërkon një investim urgjent në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, sidomos në sektorët më të ekspozuar ndaj kërcënimeve. Standardizimi sektorial i mbrojtjes kibernetike është prioritet.
- **Strukturat ndërinstitucionale dhe koordinimi:** Krijimi i një strukture ndërinstitucionale për inteligjencën kibernetike dhe dezinformimin është thelbësor për monitorimin dhe adresimin e kërcënimeve. Kjo strukturë duhet të përfshijë institucione të sigurisë si AKSK, AKSHI, SHISH dhe të tjera, për të mundësuar një përgjigje të koordinuar dhe efektive ndaj sulmeve kibernetike dhe fushatave të dezinformimit.
- **Transparenca dhe problemet me komunikimin publik:** Një çështje e rëndësishme, e raportuar është mungesa e transparencës në lidhje me sulmet kibernetike dhe masat mbrojtëse që merren. Shpesh, sulmet keqraportohen në publik, duke krijuar klimë pasigurie dhe mosbesimi në punën e institucioneve publike. Kjo shfaq nevojën për hartimin e një politike të qartë dhe të një sistemi më të mirë informimi që garanton transparencë dhe mosçënim të besimit publik.
- **Fokus në sektorët strategjikë dhe siguria kombëtare:** Sektori financiar, si një nga më të synuarit nga sulmet kibernetike dhe ndikimet e huaja keqdashëse, dikton nevojën për masa të rrepta mbrojtjeje, përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës kritike, rrjetet e internetit dhe sistemet që mbajnë të dhëna sensitive. Po ashtu, është e domosdoshme një mbikëqyrje e vazhdueshme mbi investimet/donacionet e huaja direkte dhe strategjike, për të parandaluar përfshirjen e kapitalit të dyshimtë, sidomos nga shtetet me interesa të kundërta me sigurinë kombëtare dhe atë globale.
- **Analiza dhe monitorimi i investimeve të huaja:** Aktualisht, nuk ka një analizë të thelluar të fluksit të investimeve të huaja dhe veçanërisht asaj që vjen nga shtete jomike. Kjo situatë dikton nevojën e krijimit të një sistemi adekuat kontrolli dhe monitorimi ligjor për të siguruar se ekonomia e hapur nuk do të "infektohet" nga kapitalet që mund të dëmtojnë interesat kombëtare apo të partnerëve strategjik.
- **Financimi i fushatës zgjedhore:** KQZ raporton se nuk ka instrumenta ligjorë dhe kapacitete të mjaftueshme njerëzore, për të mundësuar monitorimin dhe gjurmimin e burimit të kapitaleve të financuara nga individë, persona fizikë apo tregtarë në fushatë. Një problematikë tjetër e rëndësishme është mungesa e një definicioni të qartë për "palët e treta", përfshirë subjekte ekonomike që mund të financojnë partitë politike. Aktualisht, ka një boshllëk ligjor që nuk përfshin paratë e shpenzuara për lobimin, që është një element kyç në ndikimin e huaj në politikën shqiptare. Nevojitet ndërhyrje legjislative domethënëse, për të përfshirë të gjitha burimet e mundshme të financimit dhe lobimit, si brenda dhe jashtë vendit.
- **Media online dhe tradicionale shpesh bien pre e dezinformimit për shkak të mungesës së verifikimit të fakteve.**

- Ekspertët kanë identifikuar media specifike që janë përdorur për përhapjen e propagandës dhe dezinformimit. Informacionet përfshijnë media online dhe/ose audiovizive që janë objekt manipulimi ose vihen në shërbim të interesave të caktuara.
- Mungesa e praktikave profesionale të verifikimit të fakteve është një ndër arsyt kryesore që mediat bëhen kanale për përhapjen e informacioneve të rreme. Kjo dëmton cilësinë e informacionit dhe rrit rrezikun e polarizimit të shoqërisë.
- Hapësira digjitale e mediave online dhe atyre audiovizive është më e prekshme nga dezinformimi për shkak të shpejtësisë së publikimit dhe përhapjes së informacionit.
- Përhapja e informacionit të rremë shpesh mbështetet në platformat digjitale me qëllime të caktuara destabilizuese.
- Rritja e kërcënimeve hibride kërcënon sigurinë dhe stabilitetin e vendeve demokratike. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për BE, e konsideron prioritet të lartë parandalimin dhe menaxhimin e sulmeve hibride.
- Format e luftës hibride: Përdorimi i mjeteve ushtarake dhe jo-ushtarake, metodave të fshehta dhe të hapura. Sulme kibernetike, dezinformim, presion ekonomik dhe manipulim social për destabilizim të rendit demokratik.
- Nevoja për qasje të integruar dhe bashkëpunim ndërinstytucional përballë kërcënimeve hibride.
- Prioritetet e sugjeruara nga MB: edukimi i publikut, forcimi i infrastrukturës kritike të informacionit dhe aftësive teknologjike, forcimi i institucioneve demokratike, si dhe adresimi i rasteve të dezinformimit të brendshëm, me synim të politik, që synon destabilizim shoqëror.
- Propaganda dhe dezinformimi: Përhapje e propagandës përmes mediave sociale, mediave tradicionale dhe debateve të nxitura (investuara) kulturore dhe/ose etnike, duke shfrytëzuar tensionet fetare/etnike për qëllime destabilizimi. Mjetet kryesisht të përdorura për propagandën dhe dezinformimin, janë sulmet kibernetike, përdorimi i lajmeve të krijuara nga Inteligjenca Artificiale (kryesisht nga të ashtuquajturat “synthetic media”), si dhe manipulimi i mediave sociale, për të ndikuar në perceptimin publik.
- Sulmet kibernetike kundër Shqipërisë: Sulmi i organizuar nga Irani në korrik 2022 dhe të tjera sulme gjatë viteve 2023-2024. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë si FBI dhe Microsoft për të minimizuar dëmet.
- Rishikimi i Kodit Penal dhe legjislacioni mbi dezinformimin: Aktualisht mungon një përkufizim i qartë i “dezinformimit” në Kodin Penal. Nevoja për rishikim të Kodit Penal dhe harmonizim me legjislacionin e BE-së mbi këtë çështje.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Projektligji është propozuar nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin

*dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit*”, bazuar në përcaktimet e nenit 81, pika 1, të Kushtetutës.

#### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN**

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë akt të acquis të BE-së.

#### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në bazë të këtij projektakti, Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse dhe të integruar për mbrojtjen e qytetarëve, shoqërisë dhe institucioneve shtetërore nga ndikimet keqdashëse të ndërhyrjeve të jashtme, përfshirë dezinformimin. Dokumenti përcakton mjetet, instrumentet dhe masat që janë në përputhje me praktikat ndërkombëtare, standardet evropiane dhe angazhimet e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare. Kjo strategji synon të përballojë sfidat aktuale dhe të ardhshme në një mjedis gjeostrategjik kompleks, duke garantuar qëndrueshmërinë institucionale dhe sociale përballë ndërhyrjeve të huaja.

Një aspekt thelbësor i këtij projektakti është struktura e qartë që parashikon katër objektiva kryesore, të cilat adresojnë dimensione të ndryshme të mbrojtjes kombëtare:

- Objektivi i parë fokusohet në proceset zgjedhore, duke garantuar integritetin e votimit, transparencën e financimit politik dhe ndalimin e ndikimeve të huaja në vendimmarrjen politike.
- Objektivi i dytë përqendrohet në sigurinë kombëtare dhe kibernetike, duke forcuar aftësitë e institucioneve për të zbuluar dhe neutralizuar ndërhyrjet hibride, si dhe për të mbrojtur infrastrukturën kritike përmes mekanizmave të avancuar monitorimi dhe reagimi.
- Objektivi i tretë synon mbrojtjen e ekonomisë kombëtare, duke adresuar ndikimet e jashtme në investimet strategjike dhe infrastrukturën kritike përmes krijimit të një kuadri rregullator transparent, që siguron një ambient konkurrues dhe të qëndrueshëm ekonomik.
- Objektivi i katërt ka për qëllim mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetit të medias, duke promovuar lirinë e shprehjes, garantimin e transparencës financiare dhe krijimin e mekanizmave në mënyrë që të parandalohet dezinformimi dhe manipulimi i informacionit.

Në përmbledhje, ky projektakt ofron një qasje të balancuar dhe gjithëpërfshirëse, që përmban elementë si integriteti institucional, forcimi i kapaciteteve teknologjike dhe

operacionale, dhe harmonizimi me standardet ndërkombëtare. Përmes katër objektivave kryesore, strategjia jo vetëm adreson sfida specifike në fushat zgjedhore, sigurisë kombëtare dhe kibernetike, mbrojtjes së ekonomisë, dhe pavarësisë së medias, por gjithashtu krijon një ambient të qëndrueshëm dhe rezistentë ndaj çdo përpjekjeje për ndërhyrje keqdashëse dhe manipulim të informacionit.

Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit synon krijimin e një kornize të qëndrueshme dhe efektive për të parandaluar, zbuluar dhe adresuar kërcënimet hibride që çënojnë proceset demokratike, integritetin zgjedhor dhe sigurinë kombëtare.

Për zbatimin e kësaj strategjie, parashikohet hartimi i një Plani të Veprimit brenda vitit 2025, i cili do të mbështetet me burime financiare adekuate dhe do të mbikëqyret nga Kuvendi i Shqipërisë. Një sistem i koordinuar ndërqeveritar do të garantojë implementimin e masave, përmes një autoriteti mbikëqyrës të pavarur dhe një institucioni ekzekutiv për koordinimin operacional.

Strategjia përfshin rreth 40 masa konkrete të ndara në disa fusha kryesore:

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i mbikëqyrjes zgjedhore

- Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor zgjedhor për të ndaluar financimet e huaja dhe të dyshimta.
- Krijimi i një kuadri rregullator për auditimin e sistemeve TIK zgjedhore.
- Hartimi i një plani emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike zgjedhore.

Forcimi i transparencës financiare dhe mbikëqyrjes së fondeve politike

- Hartimi i një ligji të dedikuar për ndalimin e financimeve të huaja në zgjedhje.
- Krijimi i një platforme digjitale për transparencën financiare të partive politike.
- Miratimi i një ligji për veprimtarinë lobuese dhe ngritja e një regjistri kombëtar të lobimit.

Mbrojtja nga dezinformimi dhe ndërhyrjet digjitale

- Krijimi i një njësie të dedikuar për monitorimin e dezinformimit digjital në KQZ.
- Vendosja e rregullave për transparencën e reklamave politike online dhe monitorimi i rrjeteve sociale.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar me NATO dhe BE për ndarjen e informacionit mbi kërcënimet hibride.
- Kriminalizimi i ndërhyrjeve të huaja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale
- Përmirësimi i rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e sigurisë zgjedhore.
- Organizimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuese për qytetarët dhe zyrtarët zgjedhorë.

Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe infrastrukturës kritike

- Hartimi dhe miratimi i një ligji për shqyrtimin e investimeve të huaja, me qëllim parandalimin e ndikimeve të padëshiruara.

- Krijimi i një mekanizmi të posaçëm për shqyrtimin e financimeve të huaja në sektorët strategjikë.

Kjo strategji është një hap thelbësor për forcimin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e demokracisë nga kërcënimet hibride. Masat e parashikuara janë të shënjestruara, të realizueshme dhe të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë standardet e BE-së, OSBE-së dhe NATO-s.

Në veçanti, strategjia siguron:

- ✓ Ndërhyrje ligjore të qarta dhe të matshme për të luftuar financimet dhe ndërhyrjet keqdashëse.
- ✓ Forcim të transparencës dhe mbikëqyrjes financiare të subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore.
- ✓ Zhvillimin e një arkitekture kombëtare të sigurisë kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën zgjedhore dhe të dhënat sensitive.
- ✓ Krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit për të parandaluar dhe zbuluar dezinformimin.
- ✓ Bashkëpunim të ngushtë me organizatat ndërkombëtare për të adresuar sfidat e ndërhyrjeve të huaja dhe për të rritur qëndrueshmërinë institucionale dhe publike.

## VI. INSTITUCIONET KONTRIBUESE

Duke mbajtur në konsideratë problematikat e evidentuara në raporte ndërkombëtare, si dhe praktikat më të mira të BE-së dhe të vendeve partnere, për të adresuar çështje të ndërhyrjes së vendeve të huaja keqdashëse në proceset demokratike dhe çështje të dezinformimi, kryesisht praktikës europiane të ngritjes së Komisioneve Ad-Hoc Parlamentare, si dhe në funksion të detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin nga proceset integruese të vendit, Kuvendi miratoi me Vendimin nr. 40, datë 11.04.2024, ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar *“Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”*.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar ka si qëllim kryesor të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për identifikimin dhe administrimin e ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike të vendit, përfshirë dezinformimin, si dhe ndikimet ekonomike dhe financiare të huaja që kërcënojnë stabilitetin social-ekonomik.

Objektivat kryesorë të Komisionit përfshijnë:

1. Rishikimin e kuadrit ligjor dhe praktikës për ndalimin e ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike dhe ato zgjedhore;
2. Forcimin e kuadrit ligjor dhe masa institucionale në mbrojtjen e sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashës;

3. Rishikimin e kuadrit ligjor dhe praktikës për ndalimin e ndërhyrjeve të huaja në ekonomi dhe sektorë të tjerë kritik;
4. Mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe pluralizmin online dhe offline, aksesit në informacion, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe nxitjen e debatit publik rreth angazhimit kundër dezinformimit.

Metodologjia e veprimtarisë së këtij Komisioni mbështetet në dy parime të rëndësishme: gjithëpërfshirja dhe transparenca.

Në këtë kontekst, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij u ndoqën këto hapa kryesore:

- ✓ Analiza e situatës në të cilën ndodhet Shqipëria me rekomandimet përkatëse për masat ligjore dhe institucionale;
- ✓ Dëgjesa me institucionet, përfaqësues të medias, shoqërisë civile, etj, marrja nga praktikatat më të mira të vendeve të tjera
- ✓ Strategjia Kombëtare dhe plani i veprimit për ndërhyrjet e huaja.
- ✓ Ndërhyrjet në legjislacion / iniciativa legjislative (legjislatura e ardhshme).

Pjesë e grupit të punës së ekspertëve të administratës publike, përfshirë institucione të pavarura, kushtetuese e ekzekutive ligjzbatuese, atashuar pranë Komisionit janë 19 institucione.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi mbledhjen e tij të parë konstituente më 26 qershor 2024, ku mori katër vendime, përfshirë përfaqësimin e institucioneve dhe ftesa për bashkëpunim me ekspertë të huaj dhe të brendshëm. Më 17 korrik 2024, Komisioni miratoi metodologjinë dhe objektivat e punës së tij, ndërsa më 26 shtator 2024, u miratua kalendari i punës dhe vendimi për caktimin e 18 ekspertëve të pavarur<sup>1</sup>. Këto vendime shënojnë hapat e parë në strukturimin dhe organizimin e aktivitetit objekt i këtij Komisioni, i cili në total, ka zhvilluar 12 mbledhje, përfshirë seancat dëgjimore me institucionet.

Gjithashtu, Komisioni i Posaçëm Parlamentar ka kërkuar mbështetje ekspertizë nga institucione ndërkombëtare, si Ambasada e SHBA, Delegacioni i BE-së, OSBE, Këshilli i Europës dhe NATO, duke marrë konfirmimin për bashkëpunim.

Delegacioni i BE-së ka organizuar një workshop dy-ditor në fund të tetorit 2024 dhe një mision ekspertësh TAIEX në shkurt 2025, të cilët përcollën komente mbi draftin paraprak të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit, komente të cilat janë reflektuar në materialin e depozituar në Kuvend.

Rekomandimet e përgjithshme nga Rrjeti Ndërkombëtar i Praktikuesve (Practnet, Estoni):

---

<sup>1</sup> shtuar 1 ekspertë në janar 2025

Bazuar në përfundimet e misionit TAIEK, Rrjeti Ndërkombëtar i Praktikuesve (Practnet) nga Estonia ka bërë vëzhgimet e mëposhtme mbi procesin dhe ka dhënë rekomandime bazuar në diskutimet e zhvilluara dhe tekstin e Strategjisë. Këto rekomandime synojnë mbështetjen e zbatimit të Strategjisë dhe maksimizimin e ndikimit të saj në luftën kundër ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit në Shqipëri.

- Gjatë takimeve të misionit në Parlament u bë e qartë se procesi i hartimit të Strategjisë ka qenë gjithëpërfshirës dhe i kuptueshëm për të gjithë pjesëmarrësit, megjithëse i zhvilluar me ritëm të shpejtë për një dokument kaq të gjerë. Numri i ekspertëve dhe institucioneve të ndryshme me të cilët u takuam ishte mbresëlënëse, dhe në këtë aspekt, ky proces mund të shërbejë si model edhe për disa vende të BE-së. Lufta kundër dezinformimit dhe manipulimit të informacionit nga aktorë të huaj mund të jetë e suksesshme vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse në nivel shoqëror.
- Një element pozitiv ishte fakti që të gjithë pjesëmarrësit e njohën ekzistencën e problemit të manipulimit të informacionit në shoqërinë shqiptare dhe theksuan nevojën për të rritur ndërgjegjësimin mbi këtë çështje.
- Strategjia e paraqitur gjatë misionit krijon një bazë të mirë për Parlamentin e ardhshëm, që do të zgjidhet në maj, për të vijuar punën mbi këtë temë. Udhëheqja nga Parlamenti aktual mbi këtë çështje të ndjeshme i jep luftës kundër dezinformimit një mandat më të gjerë dhe siguron kuadrin për veprimet e ardhshme të bazuara në Strategji.
- Ne rekomandojmë që Parlamenti aktual të krijojë një mekanizëm për mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të Strategjisë dhe të përfshijë në këtë mekanizëm edhe aktorë të rëndësishëm joqeveritarë. Një mekanizëm i tillë do të siguronte vazhdimësinë e mbikëqyrjes parlamentare mbi këtë temë strategjike.
- Zbatimi i kësaj Strategjie mund të jetë i suksesshëm vetëm si një proces afatgjatë dhe gjithëpërfshirës për institucionet dhe aktorët relevantë. Ne sugjerojmë që plani i veprimit të jetë një dokument i veçantë dhe jo pjesë e Strategjisë, siç duket se ka ndodhur me disa tema. Miratimi i kësaj Strategjie duhet të përcaktojë qartë kuadrin për këtë aktivitet dhe të caktojë afatin kohor brenda të cilit plani i veprimit duhet të hartohet dhe t'i paraqitet Parlamentit të ardhshëm. Për hartimin e procesit të zbatimit mund të merren parasysh praktikatat më të mira ndërkombëtare, nëse konsiderohet e nevojshme.
- Zbatimi i Strategjisë duhet të jetë i sinkronizuar rregullisht me dokumentet kombëtare të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve. Në këtë mënyrë, nuk është e nevojshme të përfshihet një vlerësim i detajuar i kërcënimeve brenda Strategjisë vetë. Në një mjedis kërcënues që ndryshon vazhdimisht, kjo qasje do të shmangte nevojën për rishikime të shpeshta të vlerësimit të kërcënimeve në Strategji dhe do të ishte e mjaftueshme që Strategjia t'i referohej dokumenteve kombëtare të vlerësimit të kërcënimeve. Për një zbatim të suksesshëm të Strategjisë, do të kërkohet gjithsesi një kuptim i përbashkët i kërcënimeve përkatëse në shoqëri. Nëse është e nevojshme, rrjeti Practnet mund të sjellë praktikatat më të mira nga Estonia për këtë aspekt.

- Të gjithë pjesëmarrësit e Strategjisë me të cilët patëm mundësinë të takohemi panë një nevojë të qartë për një sistem të unifikuar të koordinimit ndërqeveritar për luftën kundër dezinformimit dhe manipulimit të informacionit nga aktorë të huaj. Ekzistonte gjithashtu një mirëkuptim i përbashkët se do të nevojitej një institucion i veçantë për të udhëhequr këtë sistem dhe për të zbatuar Strategjinë. Bazuar në përvojën tonë, ne e mbështesim plotësisht këtë ide dhe miratimi i Strategjisë duhet të marrë vendimet përkatëse në këtë drejtim.
- Sipas rekomandimeve të ekspertëve të Practnet, sistemi i unifikuar i koordinimit ndërqeveritar do të përfshinte një institucion mbikëqyrës të politikave në nivelin e Parlamentit të Shqipërisë dhe një institucion të veçantë në nivelin ekzekutiv të qeverisë për koordinimin operacional. Ky institucion ekzekutiv do të ishte përgjegjës për zbatimin e politikës/strategjisë së miratuar nga Parlamenti dhe për raportimin mbi progresin. Po ashtu, do të ishte përgjegjës për hartimin e Planit të Veprimit të Strategjisë dhe për sinkronizimin e tij me planet e tjera të qeverisë.
- Nëse deputetët e Parlamentit vlerësojnë se zbatimi i Strategjisë ose krijimi i sistemit të unifikuar të koordinimit ndërqeveritar kërkon ndryshime në disa akte legjislative, kjo duhet të përmendet si pjesë e Strategjisë.
- Gjatë përcaktimit të konceptit të dezinformimit në Glosarin e Strategjisë mungon një element kyç: referenca ndaj konceptit të "dëmit publik", i cili është një komponent kritik në përcaktimin e dezinformimit në BE. Fakti që dezinformimi mund të shkaktojë dëm publik për sigurinë, proceset demokratike, shëndetin e qytetarëve ose mjedisin është shumë i rëndësishëm. Për të vendosur një bazë të qartë për veprimet në përgjigje të dezinformimit, ky dëm duhet të vlerësohet dhe të shpjegohet edhe për publikun. Prandaj, ne sugjerojmë që për përcaktimin e dezinformimit të përdoret përkufizimi i dhënë në Kodin e Praktikës së BE-së për Dezinformimin të vitit 2018.

Po ashtu, janë zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe janë shprehur mbështetje nga disa organizata të shoqërisë civile dhe medias, të cilat kanë ofruar ekspertizë për Komisionin.

Më 1 korrik 2024, u zhvillua një takim me përfaqësues të mediave të akredituara pranë Kuvendit për të prezantuar qëllimin dhe objektivat e Komisionit. Ndërkohë, gjatë takimit të parë me Grupin e Punës më 11 korrik, u prezantuan objektivat dhe metodologjia e punës dhe u theksua rëndësia e bashkëpunimit për dërgimin në kohë të informacionit dhe kontribuimin me ekspertizë institucionale. Po ashtu, më 11 korrik, u zhvillua një tryezë dialogu me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias, ku u theksua rëndësia e kontributit të tyre për një vendimmarrje gjithëpërfshirëse në funksion të një sistemi demokratik të qëndrueshëm për të përballuar sfidat e të ardhmes, në çështjet e manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjeve të huaja. Më 24 korrik u zhvillua një takim me grupin e ekspertëve të institucioneve për të ndarë objektivat dhe kërkesat për informacion nga institucionet publike. Më 5 gusht u dërguan kërkesa për analizë ligjore dhe rekomandime për 15 institucione publike, për çështjet e dezinformimit dhe ndërhyrjes së huaj, dhe më 11 shtator u zhvillua një takim tjetër pune

me Grupin e Punës për të përditësuar dhe saktësuar informacionin dhe përgatitur seancat dëgjimore për tetor-nëntor 2024.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor, në mbështetje të kalendarit të punës së Komisionit, janë zhvilluar 14 seanca dëgjimore<sup>2</sup> me:

- Ministrinë e Mbrojtjes (MM) dhe Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM);
- Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ);
- Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA);
- Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK);
- Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF);
- Bankën e Shqipërisë (BSH);
- Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
- Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT);
- Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);
- Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH);
- Ministrinë e Brendshme (MB) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH).

Gjithashtu, draft-strategjia është publikuar për konsultim publik në platformën e Kuvendit si dhe në faqen zyrtare të Komisionit. Konsultimi publik ka filluar më datë 13.02.2025 dhe do të zgjasë deri më datë 28.02.2025, me kohëzgjatje 15 ditë.

Ndërkohë ky material iu është përcjellë dhe me email, anëtarëve të grupit të punës/ekspertëve të Komisionit, si dhe organizatave të shoqërisë civile e botës akademike.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie.

## **V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji dhe Strategjia, në vetvete, nuk parashikojnë efekte financiare në buxhetin e shtetit. Megjithatë, për zbatimin e strategjisë, do të hartohet një plan veprimi i detajuar, i cili do të përcaktojë masat konkrete dhe burimet e nevojshme për realizimin e saj.

---

<sup>2</sup> Mbledhjet me MM, SHISH, AKSHI-n, MB dhe DPPSH janë zhvilluar pjesërisht me dyer të mbyllura, për shkak të informacionit të klasifikuar të trajtuar gjatë këtyre mbledhjeve.

Ky plan veprimi do të hartohet në vijim, pas konstituimit të Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave të dalë nga legjislatura e ardhshme. Në këtë kuadër, ai do të përmbajë një analizë të hollësishme të burimeve financiare të mundshme, përfshirë identifikimin e mjeteve buxhetore apo burimeve të tjera të financimit, si dhe një vlerësim të ndikimit financiar që zbatimi i strategjisë mund të ketë në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, vlerësimi financiar do të mbështetet në një analizë të qartë të kostove dhe përfitimeve, duke siguruar që çdo masë e parashikuar të jetë e përputhshme me kapacitetet buxhetore dhe objektivat fiskale të vendit. Në këtë mënyrë, plani i veprimit do të mundësojë një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme në zbatimin e strategjisë, duke siguruar një shpërndarje efektive dhe të drejtë të burimeve financiare.

**STRATEGJIA  
KOMBËTARE KUNDËR  
NDËRHYRJEVE TË HUAJA  
DHE DEZINFORMIMIT  
2025-2030**

## PASQYRA E PËRMBAJTJES

LISTA E AKRONIMEVE.....	3
FJALORTH.....	4
KONTEKSTI.....	5
NË NIVEL GLOBAL.....	7
NË NIVEL RAJONAL.....	8
NË NIVEL KOMBËTAR.....	9
QËLLIMI I STRATEGJISË.....	11
OBJEKTIVAT STRATEGJIK.....	14
OBJEKTIVI I: Ngritje dhe konsolidim i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore.....	14
Përforcimi i mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave të monitorimit për proceset zgjedhore.....	14
Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e financimeve politike.....	15
Forcimi i përgjegjësisë dhe koordinimi ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja.....	15
OBJEKTIVI II: Mbrojtja e Sigurisë Kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse.....	16
OBJEKTIVI III: Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve të tjerë kritik.....	18
Përforcimi i kuadrit ligjor dhe praktikës për mbrojtjen nga ndërhyrjet e huaja në investime strategjike dhe infrastrukturë kritike.....	18
Adresimi i kërcënimeve ndaj sektorëve strategjikë dhe sistemit financiar të ekonomisë.....	19
OBJEKTIVI IV: Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes, lirisë së medias, si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik kundër dezinformimit.....	20
Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin.....	20
Mbështetja e gazetarisë investigative dhe kërkimit të pavarur të fakteve në luftën kundër dezinformimit.....	21
Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si dhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit.....	21
UDHËRRËFYESI I STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR NDËRHYRJEVE TË HUAJA DHE DEZINFORMIMIT.....	22

## LISTA E AKRONIMEVE

FIMI – Manipulimi dhe ndërhyrja e informacionit të huaj  
MSHI - Mekanizëm për Shqyrtimin e Investimeve  
Kuvendi i RSH – Kuvendi i Republikës së Shqipërisë  
KM – Këshilli i Ministrave  
KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
MEPJ - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme  
MD - Ministria e Drejtësisë  
MM - Ministria e Mbrojtjes  
MB - Ministria e Brendshme  
DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
AISM – Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes  
SHISH - Shërbimi Informativ i Shtetit  
BSH - Banka e Shqipërisë  
AIF - Agjencia e Inteligjencës Financiare  
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve  
QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit  
AMA - Autoriteti Mediave Audiovizive  
AKEP - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare  
AKSK - Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike të Shqipërisë  
AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit  
APP – Agjencia e Prokurimit Publik  
AMSHC – Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile  
SASPAC - Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës  
CSIRT – Computer Security Incident Response Team  
SOC - Security Operation Center  
BIRN – Balkan Investigative Reporting Network  
SCIDEV – The Center for Science and Innovation for Development  
FAKTOJE.AL

**Dezinformim**<sup>1</sup> - informacion i rremë ose çorientues i cili, në mënyrë akumulative:

- a. “Krijohet, paraqitet dhe shpërndahet për përfitim ekonomik ose për të mashtruar qëllimisht publikun”; dhe
- b. “Mund të shkaktojë dëm publik”, i kuptuar si “kërcënime ndaj proceseve demokratike politike dhe vendimmarrëse, si dhe ndaj të mirave publike, si mbrojtja e shëndetit të qytetarëve, mjedisit apo sigurisë”.

**Manipulimi dhe ndërhyrja e informacionit të huaj (FIMI)** – në kuptim të ndërhyrjes së huaj, i referohet përpjekjeve të qëllimshme dhe të koordinuara nga aktorë shtetërorë ose jo-shtetërorë për të manipuluar mjediset e informacionit në mënyrë që të arrihen objektiva strategjike, politike, sigurie e të tjerë.

**Keqinformim** – informacion i rremë ose i pasaktë i përhapur pa qëllim të keq, megjithëse efektet e tij mund të jenë ende të dëmshme

**Propaganda** – informacion i krijuar për të manipuluar një audiencë specifike të synuar drejt një sjelljeje ose besimi të caktuar, shpesh si pjesë e një fushate të zgjatur nga një aktor shtetëror me një axhendë politike

**Tregim/narrativë armiqësore** – një histori specifike e zhvilluar për të diskredituar ose shpifur një objektiv të caktuar

**Aktivitete informative armiqësore** – një gamë e gjerë veprimesh të koordinuara të krijuara për të mbjellë mosbesim dhe për të manipuluar opinionin, që zakonisht përfshijnë një ose të gjitha metodat dhe teknikat e mësipërme, të tilla si meme mashtruese, teori konspirative, imazhe ose video të falsifikuara, citate të nxjerra jashtë kontekstit, ose thjesht gënjeshtër të hapura që njerëzit thonë për të manipuluar të tjerët.

**Lufta hibride** – përdorimi i mjeteve ushtarake dhe joushtarake, si dhe mjeteve të fshehta dhe të hapura (përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, vendosjen e grupeve të armatosura të parregullta dhe përdorimin e forcave të rregullta) për të mjegulluar linjat midis luftës dhe paqes, krijimin e dyshimit në tek publiku i synuar me qëllim destabilizimin dhe nxitjen e ndasive sociale.

**Kapital Gërryes (*Corrosive Capital*)**: Flukset e paqarta të kapitalit, që nuk janë të orientuara nga tregu dhe kanë si objektiv të shfrytëzojnë boshllëqet e qeverisjes, për të ndikuar në zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale në vendet përfituese.

<sup>1</sup> <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/2018-code-practice-disinformation>

## KONTEKSTI

Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimin është dokument me karakter kombëtar, që mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e që pasqyron zhvillimet strategjike të politikave shtetërore për sigurinë e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit demokratik shqiptar, në përballje me ndërhyrjet e huaja keqdashëse, përfshirë dezinformimin.

Strategjia synon garantimin e mbrojtjes së interesave kombëtar, përmes një qasje të koordinuar dhe efektive për të përballuar sfidat e ndërhyrjeve të huaja keqdashëse, përfshirë dezinformimin, në ruajtje të stabilitetit dhe integritetit të proceseve demokratike të vendit.

Dezinformimi, manipulimi i informacionit dhe ndërhyrjet e huaja keqdashëse në proceset demokratike paraqesin kërcënime hibride, të cilat kanë marrë përmasa globale gjatë dekadës së fundit, duke minuar besimin në institucionet themelore të shtetit dhe funksionimin e shëndetshëm të shoqërisë demokratike.

Ky fenomen, ka ardhur si rezultat i përhapjes së qëllimshme dhe të organizuar të dezinformatave, të cilat kërcënojnë jo vetëm stabilitetin e shoqërive demokratike, por edhe rendin dhe sigurinë e shteteve. Njëkohësisht, ky proces ka detyruar aktorë ndërkombëtarë të rëndësishëm, si Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të angazhohen në ndërmarrjen e masave ligjore dhe institucionale për të mbrojtur sigurinë, ekonominë dhe proceset demokratike.

Sfera e informacionit digjital është shndërruar në një hapësirë publike të rëndësishme për diskutim dhe shkëmbim idesh, por po ashtu ka evoluar në një arenë rivalitetesh gjeostrategjike dhe konkurrencash mes aktorëve shtetërorë dhe korporativë, që po përdorin teknologjitë për të manipuluar opinionin publik dhe për të minuar demokracinë. Kjo dinamikë e rrit presionin mbi mjedisin e informacionit të hapur, duke bërë të domosdoshëm angazhimin për mbrojtjen e vlerave universale, si të drejtat e njeriut dhe liria e shprehjes në raport me sigurinë publike, në këtë hapësirë digjitale.

Për Shqipërinë, kjo çështje është veçanërisht e mpërhtë, duke pasur parasysh interesin kombëtar, kontekstin e procesit të integritetit evropian dhe përpjekjet për forcimin e institucioneve demokratike në vend. Si shoqëri, nevojitet të ndërtojmë një front të fuqishëm mbrojtës, për të siguruar mundësinë që shtetasit shqiptarë të informohen nga burime të besueshme dhe të krijojnë gjykim të pavarur dhe të bazuara në fakte. Ky angazhim i përbashkët duhet të jetë i koordinuar dhe i qëndrueshëm, duke ofruar mundësinë për forcimin e vlerave demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe të lirisë së shprehjes.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për të luftuar FIMI-n gjatë dekadës së fundit (2014–2024), veçanërisht si përgjigje ndaj kërcënimeve në rritje nga sulmet kibernetike, ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimi. Megjithatë, pavarësisht përparimeve në disa fusha, vijohet të ketë hapsira të

qenësishme në nivel ligjor, institucional dhe shoqëror, që krijojnë ekspozim ndaj ndërhyrjeve të huaja<sup>2</sup>.

Mungesa e një përkufizimi të qartë dhe e instrumenteve ligjore të dedikuara për trajtimin e FIMI, së bashku me kapacitetet e kufizuara institucionale dhe burimet e pamjaftueshme, krijojnë boshllëqe në përgjigjen kombëtare, në mënyrë gjithëpërfshirëse, ndaj kërcënimeve gjithnjë e më të sofistikuara hibride. Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”<sup>3</sup> përfshin disa elementë që kontribuojnë në mënyrë indirekte në luftën kundër FIMI-t, veçanërisht përmes përqendrimit në reagimin ndaj incidenteve kibernetike, shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Ndërkohë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2023-2028<sup>4</sup> adreson një sërë kërcënimesh të lidhura me FIMI-n, veçanërisht përmes fokusit në sigurinë kibernetike, kërcënimet nga inteligjenca e huaj dhe luftën hibride.

Peizazhi mediatik në Shqipëri paraqet sfida të shtuara në kontekstin e FIMI-t. Përqendrimi i lartë i pronësisë së medias, i dominuar nga interesa politike dhe ekonomike me ndikim të fortë, krijojnë një mjedis të përshtatshëm për vetëcensurën dhe potencialisht për ndikimet e huaja. Shumë media online operojnë me mungesë transparence në lidhje me pronësinë dhe financimin, shpesh pa politika të qarta editoriale ose pa respektuar standardet etike të gazetarisë. Kjo krijojnë një terren të përshtatshëm për përhapjen e dezinformimit si nga burimet vendase ashtu edhe nga ato të huaja<sup>5</sup>.

Përhapja e dezinformimit në Shqipëri është lehtësuar nga nivelet e ulëta të edukimit mediatik dhe besimi i kufizuar në institucionet publike. Fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe integrimi i edukimit mbi dezinformimin dhe sigurinë kibernetike në sistemin arsimor do të ndihmojnë në forcimin e aftësive të qytetarëve për të identifikuar informacionin e manipuluar dhe për të rezistuar ndaj ndikimeve të huaja keqdashëse.

Studime të realizuara nga shoqëria civile<sup>6</sup> kanë shqyrtuar përhapjen e shpejtë të dezinformimit në mediat shqipfolëse, duke evidentuar raste të shpërndarjes së informacioneve të rreme nëpërmjet mediave të lidhura me interesa të huaja. Mjedi i mediave shqipfolëse është polarizuar dhe jo-profesional, ka favorizuar shpërndarjen e dezinformimit përmes titujve sensacional dhe pa verifikim të informacionit, duke kontribuar në rritjen e paqartësisë në shoqëri, përkeqësimin e situatës së besueshmërisë së mediave, e duke shtuar mundësitë për manipulime dhe përhapje të narrativave të huaja.

<sup>2</sup> [https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/FIMI-Analytical-Report-Albania\\_SCIDEV.pdf](https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/FIMI-Analytical-Report-Albania_SCIDEV.pdf) (fq.5)

<sup>3</sup> <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/ligj-2024-03-21-25-5.pdf>

<sup>4</sup> <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/02/08/14/6f7aeb09-5b35-4f1b-83a8-bab03464a153;q=strategji>

<sup>5</sup> [https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/FIMI-Analytical-Report-Albania\\_SCIDEV.pdf](https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/FIMI-Analytical-Report-Albania_SCIDEV.pdf) (fq.6)

<sup>6</sup> Përhapja e disinformimit rus në mediat shqipfolëse - DisInfo.AL, <https://disinfo.al/diplomacia-publike-e-kines-ne-shqiperi/>, <https://disinfo.al/propaganda-e-iranit-ne-giuhen-shqipe/>, DisInfo.AL, <https://faktoje.al/dezinformimi-per-politikat-e-be-se/>, <https://faktoje.al/wp-content/uploads/2024/07/Studimi-mbi-dezinformimi-shqip.pdf>, <https://faktoje.al/category/projekte/iniciativa-raionale-per-luften-ndaj-disinformimit/>

Një tjetër fenomen i evidentuar është pamundësia e medias për të ofruar gazetari profesionale e të pavarur. Mediat shpesh publikojnë deklarata nga subjekte politike pa i verifikuar ato, duke kontribuar kështu në rritjen e ndasive sociale e duke lehtësuar krijimin e një mjedisi shoqëror të ndikueshëm nga aktorët e huaj keqdashës. Mungesa e transparencës, profesionalizmit, verifikimit të fakteve dhe vetëcensura frenon zhvillimin e një mjedisi mediatik të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Shqipëria do të vijojë bashkëpunimin me strukturat e dedikuara të NATO-s dhe BE-së për mbrojtjen ndaj FIMI-t dhe sulmeve kibernetike, përmes shkëmbimit të informacionit, trajnimeve dhe zhvillimit të infrastrukturës teknologjike për zbulimin dhe kundërshtimin e kërcënimeve hibride.

Përballë kërcënimeve të tilla, Shqipëria duhet të investojë në mënyrë domethënëse në përmirësimin e mbrojtjes kombëtare, të infrastrukturës kritike dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, si detyrim ndaj shtetasve të saj dhe partnerëve strategjik.

Parandalimi i ndërhyrjeve të huaja është thelbësor për mbrojtjen e integritetit kombëtar dhe demokratik. Shqipëria, pavarësisht mbrojtjes së siguar nga angazhimet e saj ndërkombëtare, mbetet e ekspozuar ndaj ndikimeve të huaja për shkak të boshllëqeve në kuptimin e këtij fenomeni. Për shkak të vendndodhjes strategjike dhe rëndësisë në tregtinë dhe sigurinë evropiane, Ballkani Perëndimor është shndërruar në një fushëbetejë moderne të rëndësishme në konkurrencën për pushtet global, ku aktorë të ndryshëm synojnë të avancojnë interesat e tyre përmes mekanizmave si financimi politik, ndikimi në informacion dhe investimet strategjike, të cilat krijojnë varësi ekonomike dhe politike<sup>7</sup>.

Në këtë kuadër, gjithashtu angazhimi për një mjedis informacioni të hapur, transparent, profesional dhe të besueshëm, është më i domosdoshëm se kurrë. Ky angazhim duhet të vijë përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, mediave dhe aktorëve ndërkombëtarë, për të garantuar që Shqipëria të jetë e fortë në këto sfida duke siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe demokratike.

## NË NIVEL GLOBAL<sup>8</sup>

Teknologjitë në zhvillim paraqesin sfida të reja për sigurinë ndërkombëtare, me një gamë të gjerë kërcënimesh, që përfshijnë sulmet kibernetike, manipulimin e informacionit dhe keqpërdorimin e inteligjencës artificiale për qëllime strategjike. Dezinformimi dhe lufta hibride janë bërë mjete

<sup>7</sup> [ALBANIAN The Vulnerability of Albanian Politics to Foreign Interference FINAL.pdf](#)

<sup>8</sup> [https://www.nato.int/nato\\_static\\_fl2014/assets/pdf/2021/4/pdf/2104-factsheet-cyber-defence-en.pdf](https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2021/4/pdf/2104-factsheet-cyber-defence-en.pdf)

<https://www.nato-pa.int/download-file?filename=/sites/default/files/2023-10/CDS%20resolution%20483%20-%20DISINFORMATION.pdf>

<https://eeas.eu.com/sites/default/files/documents/2024/Study%20international%20norms%20on%20FIMI.pdf>

kyçe për aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë, të cilët kombinojnë propagandën, manipulimin e informacionit dhe aktivitetet kibernetike për të destabilizuar shoqëritë dhe për të cënuar besimin në institucionet demokratike.

Këto fushata të organizuara përdorin taktika të sofistikuar për të ndikuar në opinionin publik, duke përfshirë aktorë shtetërorë, grupe interesi apo individë me qëllime të ndryshme, për t'i përhapur nga korporatat deri te ekstremistët. Me kosto të ulët dhe përhapje të shpejtë, dezinformimi është shndërruar në një armë të fuqishme në luftën hibride, e cila synon të minojë kohezionin shoqëror, stabilitetin institucional dhe sigurinë kombëtare.

Kriza globale e shkaktuar nga pushtimi Rus i Ukrainës ka nxjerrë në pah strategjitë e ndikimit keqdashës të saj, të cilat synojnë të minojnë stabilitetin demokratik dhe integrimin euroatlantik të vendeve të ndryshme, duke ndjekur një qasje agresive përmes një kombinimi taktikash hibride, duke përfshirë dezinformimin, mbështetjen për lëvizjet separatiste dhe instrumentalizimin e varësive ekonomike dhe energjetike për të ushtruar presion mbi shtetet.

Katër kërcënimet kryesore që burojnë nga ky ndikim keqdashës përfshijnë:

- (1) minimin e agjendës euroatlantike dhe të ndikimit perëndimor për të ruajtur një status quo të favorshme për Moskën,
- (2) destabilizimin dhe dobësimin e qeverive vendase përmes mjeteve hibride,
- (3) promovimin e autoritarizmit për të penguar zhvillimin e demokracive funksionale dhe
- (4) dëmtimin e marrëdhënieve të vendeve të synuara me BE, SHBA dhe NATO.

## NË NIVEL RAJONAL<sup>9</sup>

Ballkani Perëndimor mbetet një rajon i ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe fushatave të dezinformimit, për shkak të historisë së tij të pasluftës, tranzicionit demokratik dhe sfidave të vazhdueshme ekonomike e institucionale. Këto dobësi e bëjnë rajonin veçanërisht të cenueshëm ndaj manipulimit të informacionit, ku dezinformimi shërben si një instrument për të minuar stabilitetin politik, për të dobësuar besimin e qytetarëve te institucionet dhe për të penguar integrimin euroatlantik.

Kaosi informativ në rajon pasqyron tensionet politike dhe sociale, ndërsa narrativat e bazuara në identitet etnik dhe fetar përdoren për të manipuluar opinionin publik dhe për të përkeqësuar ndasitë. Prezenca e korrupsionit përkeqëson situatën, duke amplifikuar mungesën e besimit midis qytetarëve dhe qeverive të tyre duke krijuar kështu një terren të përshtatshëm për përhapjen e dezinformimit.

Në Ballkanin Perëndimor, dezinformimi është gjithashtu një mjet i përdorur nga aktorë të huaj për të ndikuar proceset demokratike dhe orientimin gjeopolitik të rajonit.

---

<sup>9</sup> [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO\\_STU\(2020\)653621\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf)

Nëpërmjet fushatave të organizuara të dezinformimit dhe propagandës, Rusia ka synuar të nxisë ndasi politike, etnike dhe fetare, duke krijuar tensione të brendshme që dobësojnë institucionet demokratike dhe pengojnë procesin e anëtarësimit në BE dhe NATO. Kjo qasje reflekton një model të njohur të strategjisë ruse, e cila synon të minojë kohezionin politik dhe social të shteteve, duke përdorur mjete jo-konvencionale për të arritur objektivat e saj gjeopolitike.

Në këtë kontekst, Shqipëria luan një rol kyç stabiliteti përmes forcimit të bashkëpunimit rajonal, rritjes së kapaciteteve mbrojtëse dhe qëndrueshmërisë institucionale përballë këtyre kërcënimeve. Si një vend i angazhuar për integrimin europian dhe vend anëtar i NATO-s, Shqipëria promovon sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, duke synuar një mjedis më rezistent ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja. Përmes politikës së saj diplomatike dhe bashkëpunimit strategjik me partnerët ndërkombëtarë, Shqipëria mbetet një faktor kyç në forcimin e arkitekturës së sigurisë rajonale dhe në mbrojtjen e vlerave demokratike në këtë hapësirë gjeopolitike komplekse dhe me shumë sfida.

#### NË NIVEL KOMBËTAR<sup>10</sup>

Shqipëria, si vend me orientim euro-atlantik dhe anëtar i NATO-s, përballet me kërcënime nga aktorë globalë që synojnë të destabilizojnë vendin dhe të pengojnë proceset eurointegruese. Fushatat dezinformuese, lajmet e rreme dhe ndërhyrjet në proceset demokratike synojnë dobësimin e demokracisë, cënimin e balancave të aleancave strategjike dhe orientimin negativ në perceptimin publik. Aleati më i madh i interesit publik në këtë betejë është media dhe për këtë arsye garantimi i transparencës, profesionalizmit, lirisë së shprehjes dhe integritetit të saj, mbeten sfidat kryesore në përballimin e këtyre kërcënimeve.

Krahas institucioneve, organizatave, ekonomisë dhe infrastrukturës digjitale dhe asaj kritike të Shqipërisë, një terren i synuar i manipulimit dhe dezinformimit të huaj ka qenë dhe mbetet edhe mjedisi i informimit dhe i komunikimit masiv/publik. Qëllimet e depërtimit të huaj në këtë fushë, variojnë që nga përhapja e mesazheve dhe e informacioneve që çënojnë imazhin e Aleancës euro-atlantike dhe sistemit të demokracisë liberale, tek dezinformimi lidhur me krizat, proceset dhe zhvillimet aktuale globale, si dhe përpjekja për të nxitur përçarje, keqorientim dhe konfuzion informues në radhët e vetë shoqërisë shqiptare.

Rusia përbën aktualisht kërcënimin kryesor të sigurisë për aleancën perëndimore, pjesë e së cilës është sot edhe Shqipëria. Pikërisht në këtë kontekst merr formë dhe zhvillohet edhe manipulimi informues që vjen prej këtij vendi. Forma kryesore e manipulimit rus është dezinformimi, por ndeshen edhe raste të propagandës dhe të keqinformimit.

Kanalet kryesore të dezinformimit rus në Shqipëri dhe më gjerë janë, RT International dhe Sputnik – dy rrjete televizive të kontrolluara nga shteti me prezencë të ndjeshme edhe në mjedisin global

---

<sup>10</sup> NDI The Vulnerability of Albanian Politics to Foreign Interference FINAL.pdf

online – të cilat, nëpërmjet platformave të tyre ndërkombëtare i shërbejnë qëllimeve të politikës së jashtme të Kremlinit. Por publiku shqiptar është i ekspozuar edhe ndaj mesazheve dezinformuese që vijnë prej gazetës Pravda (dikur organ i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik), e cila është e vetmja media e këtij vendi që ka një seksion në gjuhën shqipe. Gjithsesi, duhet nënvizuar se, pavarësisht pranisë së aty-këtushme, operacionet dezinformuese ruse gjejnë shumë pak terren në Shqipëri për shkak të orientimit të fortë gjeopolitik pro-perëndimor të shoqërisë.

Nga monitorimet e kryera në mediat shqiptare tradicionale, ato online si dhe të rrjeteve sociale, rezulton se linjat kryesore të diskursit dezinformues rus që kanë depërtuar në to janë: paraqitja e SHBA dhe NATO si agresive dhe si kërcënim për Rusinë; përlligjja e pushtimit rus të Ukrainës; diskretitimi i luftës së Ukrainës në mbrojtje të sovranitetit territorial të saj; paraqitja e Perëndimit si armiqësor dhe rusofob dhe si faktor pengues për përpjekjet e paqes në Ukrainë; diskretitimi i BE-së dhe akuza për humbjen e sovranitetit të shteteve të saj; retorika e mosnjohjes së Kosovës si shtet i pavarur; evokimi i të ashtuquajturës ndihmë të dikurshme ruse ndaj Shqipërisë, etj.

Në fushata dezinformuese apo propogandistike në plan global, janë përdorur intensivisht si “*trolls*” dhe “*bots*”, po ashtu edhe influencerat, për të amplifikuar ndikimin dhe arritjen e tyre tek publiku global. Ndërkohë janë përdorur edhe kapacitetet e algoritmeve për të mundësuar përhapjen e gjerë të informacioneve të rreme, shumëfishimin elektronik artificial të postimeve, operimin e llogarive false për nevoja të fushatave të targetuara, etj.. Gjithsesi kur bëhet fjalë për mediat tradicionale apo digjitale shqiptare, këto taktika apo mjete të aktorëve të tretë nuk kanë patur një prani apo përdorim të zëshëm.

Shqipëria synon parandalimin, identifikimin dhe kundërveprimin aktiv ndaj këtyre fenomeneve, duke nënvizuar rëndësinë e krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm për të adresuar këto çështje kryesisht përmes përmirësimit të legjislacionit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe edukimit publik e mediatic.

## QËLLIMI I STRATEGJISË

Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhryjeve të Huaja dhe Dezinformimit përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga ndërhryjet e huaja keqdashëse, përfshirë dezinformimin. Ajo ka objektiv përballimin e sfidave të mundshme në të tashmen dhe të ardhmen, duke marrë në konsideratë mjedisin gjeostrategjik.

Qëndrueshmëria nënkupton aftësinë e shtetit dhe shoqërisë për të përballuar ndërhryjet e huaja sporadike, të vazhdueshme dhe intensive për të mënjeluar/minimizuar ndikimin negativ dhe për të rivendosur funksionalitetin e plotë në rast dëmtimi.

Tipari themelor i Strategjisë kundër Ndërhryjeve të Huaja dhe Dezinformimit është respektimi i shtetit të së drejtës. Kjo strategji mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin shqiptar. Ajo respekton marrëveshjet, traktatet e konventat ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, duke synuar përafrimin dhe përputhshmërinë me standardet europiane dhe euroatlantike.

Ndërhryja e huaj keqdashëse përfshin veprime të hapura dhe të fshehta, nga aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë, të cilat synojnë elementë të çënueshëm të shteteve dhe shoqërive demokratike, me qëllim dobësimin e funksionimit të institucioneve demokratike, sundimit të ligjit dhe sigurisë së brendshme, duke përdorur instrumente politik, diplomatik, ushtarak, ekonomik, financiar, ligjor apo të shërbimeve inteligjente etj. Ky synim përfshin gjithashtu ndikimin në partitë dhe vendimmarrjen politike, sistemin gjyqësor dhe median, duke kërcënuar seriozisht integritetin shtetëror dhe atë shoqëror.

Ndërhryja e huaj synon të zhbëjë kufijtë dhe ekuilibrat mes paqes, krizës dhe konfliktit, duke prodhuar qëllimshëm situata të paidentifikueshme, të paqarta dhe komplekse në identifikimin dhe gjurmimin e burimit, por edhe në paralizimin e procesit të vendimmarrjes politike apo cënimit e besimit të qytetarëve në mekanizmat garantues të rendit kushtetues dhe të drejtave themelore të njeriut. Gjithashtu, ndikimi mund të shfaqet edhe në procese ekonomike/financiare për të fituar ndikim në sektorë kyç strategjik, të manipulojë ose të marrë kontroll mbi mjedisin informativ, si dhe në cënimin e funksionimit të infrastrukturës kritike.

Ndërhryjet e huaja përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm për Shqipërinë, duke ndikuar në stabilitetin politik, sigurinë kombëtare dhe besimin e qytetarëve tek institucionet demokratike. Përhapja e lajmeve të rreme dhe manipulimi i informacionit përdoren nga aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë për të dobësuar kohezionin shoqëror, për të ndikuar opinionin publik dhe për të minuar proceset euro-integruese të vendit.

Identiteti kombëtar, historia e përbashkët dhe orientimi euroatlantik i Shqipërisë shërbejnë si elementë unifikues që forcojnë kohezionin shoqëror dhe mobilizimin kundër FIMI-t. Promovimi i kulturës, traditave dhe kontributit të diasporës shqiptare në arenën ndërkombëtare ndihmon në ndërtimin e një mjedisi informativ më rezistent ndaj manipulimit. Përmes koordinimit të ngushtë

kombëtar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, Shqipëria do të forcojë rolin e saj si një vend rezistent ndaj FIMI-t.

Për Shqipërinë, si anëtare e NATO-s dhe kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, siguria kombëtare është e ndërvarur me zhvillimet e sigurisë ndërkombëtare. Ndërhyrjet e huaja hibride, që përfshijnë sulmet kibernetike dhe manipulimin e informacionit, kërkojnë një përgjigje të koordinuar kombëtare dhe ndërkombëtare. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit dy e më shumë palësh dhe i standardeve të integritetit do të lidhet ngushtë edhe me vijimin e kontributit konkret të Shqipërisë në interes të paqes e sigurisë rajonale e globale.

Siguria e Republikës së Shqipërisë është e pandashme nga siguria e rajonit euroatlantik. Për këtë arsye, Strategjia bazohet në dokumentet strategjike themelore të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe Bashkimit Evropian (BE). Ajo mbështetet në parimin e solidaritetit midis aleatëve të NATO-s dhe vendeve anëtare të BE-së.

Strategjia kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit është një strategji aktive veprimi, e cila përcakton jo vetëm interesat, objektivat dhe prioritetet e vendit, mekanizmat dhe masat kryesore për realizimin e tyre, por edhe ngritjen e një strukturë të dedikuar, në funksion të përballjes e adresimit të sfidave të ndërhyrjeve të huaja, përfshirë dezinformimin. Synimi është mbrojtja dhe garantimi i interesave kombëtare dhe atyre strategjik, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, rritjes së vigjilencës dhe përgjigjes energjike ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse në procese demokratike, infrastrukturë kritike dhe ekonomi.

Struktura e dedikuar do të ketë përgjegjësi për identifikimin, analizimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e veprimtarive të lidhura me FIMI-n në agjenci dhe institucione të ndryshme publike.

Rolet, detyrat dhe kanalet e komunikimit për secilin aktor: institucione publike, akademi, shoqëri civile, media dhe sektorin privat, duhet të përcaktohen qartë në aktet ligjore e nënligjore, në zbatim të kësaj strategjie, me synim sigurimin e një platforme të përbashkët për shkëmbimin e burimeve, inteligjencës, ekspertizës dhe të dhënave mbi rastet dhe kërcënimet e FIMI-së.

Republika e Shqipërisë do të hartojë një kornizë të përbashkët, bazuar në evidenca dhe në vlerësim risku, që mundëson identifikimin, analizimin dhe përgjigjen ndaj FIMI-t në mënyrë sistematike, të koordinuar dhe të vazhdueshme. Korniza duhet të optimizojë krijimin, shkëmbimin dhe aktivizimin e njohurive, duke u mbështetur në standarde me burime të hapura dhe bashkëpunuese, si dhe duke siguruar transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e të dhënave.

Republika e Shqipërisë për të mundësuar përgjigje më të shpejtë e më efektive do të përdorë modele analitike për të vlerësuar sa shpejt mund të përhapet një narrativë manipuluese dhe ndikimin e saj.

Republika e Shqipërisë përcakton si qëllime strategjike ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse, pacënueshmërinë e shoqërisë, shtetit, infrastrukturës kritike, ekonomisë si dhe qasjen sistematike dhe gjithëpërfshirëse për reagim efektiv dhe të menjëhershëm.

Ruajtja e stabilitetit dhe sigurisë ndaj sfidave të ndërhyrjeve të huaja keqdashëse do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit legjislativ specifik, zbatimit rigoroz të tij dhe monitorimit periodik. Garantimi afatgjatë i interesave kombëtarë kërkon përafrimin e legjislacionit në këto fusha në përputhje me *Acquis* e Bashkimit Evropian.

Përdorimi bashkëkohor i informacionit në mbështetje të sigurisë kombëtare është thelbësor. Sigurimi i shpejtë dhe i saktë i informacionit është i lidhur pazgjidhshmërisht me vendimmarrjen e duhur dhe veprimet e shpejta për neutralizimin e pasojave që mund të dëmtojnë sigurinë kombëtare. Strategjia e vlerëson informacionin si një faktor shumë të rëndësishëm për forcimin e sigurisë kombëtare, duke respektuar njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve, si dhe lirinë e mediave. Ruajtja e sigurisë kombëtare kërkon më së pari ndalimin e përdorimit të informacionit për qëllime manipulimi të ndërgjegjes publike.

Republika e Shqipërisë duke njohur dhe vlerësuar si angazhim të kryer, transparencën financiare dhe të marrëdhënieve të pronësisë së mediave audiovizive, në referim të rekomandimeve të lëna në Progres-Raportet e Komisionit Evropian<sup>11</sup>, do të garantojë të njëjtën transparencë financiare dhe marrëdhënieve të pronësisë për median online që ushtron veprimtari në territorin shqiptar. Ky angazhim do të kryhet në linjë me standardet e lirisë së shprehjes së Këshillit të Evropës dhe standardet e Bashkimit Evropian, sipas Aktit Evropian për Lirinë e Medias, Aktit për Shërbimet Digjitale, Aktit për Tregun Digjital.

Republika e Shqipërisë angazhohet të forcojë mbikëqyrjen parlamentare për ndërhyrjen e huaj, përfshirë dezinformimin, duke rritur kapacitetet institucionale dhe ekspertizën për identifikimin, analizimin dhe adresimin e këtyre kërcënimeve.

---

<sup>11</sup> [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf) (fq 7, 35 etj).

## OBJEKTIVAT STRATEGJIK

**OBJEKTIVI I: NGRITJE DHE KONSOLIDIM I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR TË PARANDALUAR, ZBULUAR DHE ANALIZUAR NDËRHYRJET E HUAJA NË FUSHATAT ZGJEDHORE**

### **PËRFORCIMI I MBROJTJES LIGJORE DHE MEKANIZMAVE TË MONITORIMIT PËR PROCESET ZGJEDHORE**

Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar për të forcuar mbrojtjen e integritetit të zgjedhjeve dhe mekanizmave të financimit politik, përfshirë mundësinë e financimit të fushatave dhe partive politike nga burime të dyshimta ose të huaja, përfshirë zhvillimin e politikave që parandalojnë përdorimin e fondeve të paligjshme për mbështetje të kandidatëve ose subjekteve politike me qëllime ndërhyrjeje.

Republika e Shqipërisë do të mbrojë proceset demokratike dhe zgjedhore nga ndërhyrjet e huaja, duke zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse të harmonizuar me praktikatat më të mira të BE-së, OSBE-së/ODIHR-it dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë. Masat strategjike do të përfshijnë forcimin e sigurisë kibernetike, rritjen e transparencës financiare, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim garantimin e integritetit zgjedhor dhe rritjen e rezistencës ndaj kërcënimeve hibride dhe kibernetike.

Republika e Shqipërisë do të ndërmarrë masa për forcimin e transparencës në veprimtarinë financiare të partive politike, për të siguruar monitorimin e burimeve financiare dhe shpenzimeve të partive politike, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve të huaja dhe ruajtjen e integritetit të proceseve zgjedhore.

Republika e Shqipërisë do të implementojë një kuadër të qartë ligjor për të garantuar ndalimin e financimeve nga burime të huaja në proceset zgjedhore, duke përfshirë zhvillimin e një platforme digjitale për transparencë financiare, forcimin e kapaciteteve të institucioneve mbikëqyrëse dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për identifikimin dhe ndëshkimin e financimeve të paligjshme, si pjesë e përpjekjeve për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe avancimit në procesin e integritetit në BE.

---

## RRITJA E TRANSPARENCËS DHE KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIMEVE POLITIKE

Republika e Shqipërisë angazhohet të rregullojë shpenzimet e palëve të treta gjatë zgjedhjeve, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie, në përputhje me rregulloret e Bashkimit Evropian mbi financimin e fushatave politike dhe elektorale.

Republika e Shqipërisë do të rregullojë rrjetet sociale dhe reklamat politike online përmes miratimit të rregullave që kërkojnë transparencë të plotë për reklamat politike, përfshirë deklarin e sponsorëve dhe burimeve financiare. Do të krijohet një platformë digjitale kombëtare për monitorimin e përmbajtjeve politike online, duke bashkëpunuar me rrjetet sociale ndërkombëtare. Shqipëria do të implementojë masa për luftimin e dezinformimit dhe përmbajtjeve manipuluese gjatë fushatave zgjedhore dhe do të zhvillojë platforma të posaçme për monitorimin e reklamave politike. Po ashtu, do të forcohet bashkëpunimi me platformat ndërkombëtare për të identifikuar dhe bllokuar përmbajtje të tilla.

Republika e Shqipërisë do të krijojë mekanizma mbikëqyrës të pavarur dhe efektivë, duke fuqizuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me burime teknologjike dhe financiare për monitorimin e shpenzimeve politike në kohë reale, dhe duke ngritur një autoritet të pavarur për mbikëqyrjen e transparencës financiare dhe adresimin e shkeljeve lidhur me ndikimet e huaja. Shqipëria do të vendosë sanksione të qarta dhe të ashpra për shkeljet që lidhen me mosrespektimin e transparencës dhe burimeve të paligjshme financiare.

Republika e Shqipërisë do të rregullojë aktivitetin e palëve të treta në fushatat zgjedhore, për t'u regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), duke deklaruar burimet e financimit dhe lidhjet e tyre. Mekanizmat e mbikëqyrjes për aktivitetet e palëve të treta duhet të forcohen, duke përcaktuar gjithashtu sanksione të qarta për shkeljet. Një databazë publike për kontributet e palëve të treta mund të përmirësojë më tej llogaridhënien dhe transparencën.

---

## FORCIMI I PËRGJEGJËSISË DHE KOORDINIMI NDËRMJET AKTORËVE PUBLIKË DHE PRIVATË PËR PARANDALIMIN E NDËRHJRJEVE TË HUAJA

Republika e Shqipërisë do të adresojë dezinformimin dhe manipulimin e informacionit digjital duke kërkuar transparencë të plotë për reklamat politike në platformat e rrjeteve sociale, përfshirë deklarin e burimeve të financimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të krijojë një njësi të dedikuar për monitorimin dhe reagimin në kohë reale, në bashkëpunim me nismat ndërkombëtare si Sistemi i Paralajmërimit të Shpejtë të BE-së (RAS), për të identifikuar dhe adresuar fushatat e dezinformimit ndërkufitar.

## OBJEKTIVI II: MBROJTJA E SIGURISË KOMBËTARE NGA NDËRHJRJET E HUAJA KEQDASHËSE

Republika e Shqipërisë, në funksion të sigurisë kombëtare, duhet të forcojë aftësinë për të zbuluar hershëm aktivitetet hibride armiqësore, identifikimin e burimit të tyre, si dhe aftësinë për reagim të menjëhershëm. Republika e Shqipërisë duhet të jetë në gjendje të identifikojë ndërhyrjet hibride dhe të reagojë ndaj tyre në mënyrë të duhur.

Republika e Shqipërisë do të garantojë qëndrueshmërinë e sigurisë, mirëfunksionimin shtetëror dhe të shoqërisë, përmes qasjes gjithëpërfshirëse të rezistencës dhe reagimit që kërkon ky fenomen. Kjo qëndrueshmëri do të konsolidohet duke identifikuar dhe energjizuar menjëherë pikat e dobta që mund shfrytëzohen nga autorët e ndërhyrjes hibride.

Republika e Shqipërisë do të forcojë kapacitetet e entiteve përgjegjëse publike e private të elementëve të infrastrukturës kritike për të garantuar funksionalitetin në rastet kur mund të jenë objektivi i ndërhyrjes hibride.

Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të forcojë aftësinë për të identifikuar dobësitë dhe për të kryer teste për simulimin e efekteve të ndërhyrjes hibride në infrastrukturën publike dhe atë kritike. Në këtë fushë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të kërkojë të rrisë bashkëpunimin me sektorin privat, median, organizatat jofitimprurëse dhe sistemin arsimor.

Republika e Shqipërisë do të ndërtojë një sistem të komunikimit strategjik që do të jetë në gjendje të ndajnë informacion në mënyrë efektive, koherente, të besueshme dhe në kohë me publikun dhe audienca të tjera të caktuara. Ky sistem duhet të veprojë si në mënyrë të vazhdueshme dhe preventive, ashtu edhe në përgjigje të emergjencave dhe krizave specifike. Sistemi duhet të bazohet në koordinimin dhe sinkronizimin e aktiviteteve të komunikimit mes të gjitha ministrive dhe institucioneve publike.

Për të kundërshtuar me efektivitet ndërhyrjet hibride, duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional. Republika e Shqipërisë do të rrisë aftësinë e koordinimit dhe ndarjes së informacionit mes të gjitha aktorëve të brendshëm të rëndësishëm. Kjo do të bëhet me qëllim të mbulimit të të gjithë spektrit të mjeteve që përdoren nga ndërhyrjet hibride dhe ofrimit të një ndërgjegjësimi të qëndrueshëm të situatës me cilësi të përshtatshme.

Republika e Shqipërisë do të verifikojë rregullisht gatishmërinë e sistemit të saj të sigurisë për të kundërshtuar ndërhyrjen hibride përmes stërvitjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Rezultatet e këtyre stërvitjeve do të përdoren në përpjekjet e mëtejshme për të bërë sistemin e sigurisë më efikas.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe BE është instrumenti kryesor për të dekurajuar autorët e ndërhyrjes hibride. Prandaj, Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në aktivitete dhe iniciativa të NATO-s dhe BE-së për kundërshtimin e ndërhyrjes hibride. Republika

e Shqipërisë do të synojë të përdorë aftësitë e NATO-s dhe BE-së për kundërshtimin e ndërhyrjes hibride, si dhe të kontribuojë në mënyrë të prekshme në këto aftësi.

Solidariteti dhe mbështetja e ndërsjellë mes aleatëve të NATO-s dhe shteteve anëtare të BE-së përbëjnë një instrument efektiv për parandalimin e ndërhyrjes hibride dhe përgjigjen ndaj manifestimeve të saj specifike. Prandaj, Republika e Shqipërisë do të mbështesë aktivisht unitetin dhe solidaritetin e aleatëve të NATO-s dhe shteteve anëtare të BE-së, duke përfshirë mundësinë e identifikimit kolektiv të aktiviteteve hibride armiqësore, që mund të dekurajojnë autorët që të vazhdojnë aktivitetin e tyre.

Republika e Shqipërisë do të vijojë bashkëpunimin me NATO-n dhe BE-në, që është thelbësor për të mbuluar të gjithë spektrin e mjeteve hibride të përdorura. Në këtë drejtim, Republika e Shqipërisë do të kontribuojë në aktivitetet e iniciativave të tjera ndërkombëtare, përfshirë Qendrën Evropiane të Ekselencës për Kundërveprimin ndaj Kërcënimeve Hibride në Helsink, Finlandë.

Republika e Shqipërisë do të zhvillojë aftësitë reaguese për të dekurajuar aktorët e ndërhyrjeve hibride, duke mundësuar një përgjigje efikase dhe në kohë, me fokus të veçantë në rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe partnerëve shoqërorë, me qëllim mbrojtjen e interesave të saj.

Republika e Shqipërisë do të zhvillojë sistemin e saj të komunikimit strategjik, në rastet e ndërhyrjeve të huaja, për të koordinuar veprimet reaguese dhe komunikuar qëndrimin shtetëror të saj të koordinuar me aleatët strategjik. Ky komunikim do të jetë i hapur për audiencën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Republika e Shqipërisë angazhohet për zhvillimin e fushatave të gjera ndërgjegjësuese për qytetarët, të përqendruara në identifikimin e taktikave të dezinformimit dhe nxitjen e mendimit kritik, për të garantuar reagimin publik ndaj fushatave të manipulimit të informacionit, në partneritet të ngushtë me shoqërinë civile dhe median. Në këtë kuadër, do të sigurohet mbështetje për edukimin dhe trajnimin e qytetarëve, në mënyrë efikase, në funksion të ndërgjegjësimit dhe rezistencës ndaj dezinformimit dhe manipulimeve mediatike.

Republika e Shqipërisë angazhohet të vazhdojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin me NATO-n dhe BE-në, me qëllim forcimin e mbrojtjes kombëtare kundër ndërhyrjeve të huaja, përfshirë dezinformimin, si partneritete jetike për shfrytëzimin e ekspertizës teknike, shkëmbimin e inteligjencës dhe burimeve kibernetike.

Republika e Shqipërisë do të avancojë kapacitetet kombëtare për monitorimin dhe reagimin ndaj incidenteve kibernetike, duke forcuar CSIRT dhe SOC, si dhe duke vendosur mekanizma të detyrueshëm raportimi dhe penalitete për shkeljet e sigurisë.

Republika e Shqipërisë angazhohet për përmirësimin e bashkëpunimit me sektorin privat, përmes forcimit të partneritetit dhe krijimit të mekanizmave të përbashkët për parandalimin dhe reagimin ndaj këtyre kërcënimeve.

## OBJEKTIVI III: MBROJTJA E EKONOMISË KOMBËTARE DHE SEKTORËVE TË TJERË KRITIK

### PËRFORCIMI I KUADRIT LIGJOR DHE PRAKTIKËS PËR MBROJTJEN NGA NDËRHYRJET E HUAJA NË INVESTIME STRATEGJIKE DHE INFRASTRUKTURË KRITIKE

Forcimi i kuadrit ligjor dhe praktikës që mbrojnë ekonominë kombëtare nga ndikimet dhe ndërhyrjet keqdashëse të huaja në sektorë të rëndësishëm, si investimet strategjike, financimi i infrastrukturave kritike dhe procedurat e prokurimit publik. Ky objektiv synon identifikimin e boshllëqeve ligjore dhe zhvillimin e masave për të parandaluar ndikimet e huaja që mund të dëmtojnë interesat ekonomike dhe sigurinë kombëtare.

Republika e Shqipërisë angazhohet të miratojë kuadër rregullator për krijimin e një mekanizmi të shqyrtimit të investimeve të huaja, në përputhje me direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian, duke vendosur standarde të qarta mbi sigurinë kombëtare, infrastrukturën dhe teknologjitë kritike, si dhe mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe pluralizmit mediatik. Ligji i ri do të synojë rritjen e transparencës në investime dhe adresimin e sfidave që lidhen me teknologjitë e avancuara dhe ndikimin e investimeve në konkurrencën e tregut.

Republika e Shqipërisë do të ndërmarrë reforma ligjore për përmirësimin e mëtejshëm të akteve rregullatore për tregjet e kapitalit në përputhje me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së: Zhvillimi i burimeve alternative të financimit dhe kufizimi i keqpërdorimit të sistemit financiar nga aktorë të huaj të paautorizuar.

Republika e Shqipërisë me qëllim garantimin e sigurisë kombëtare e mbrojtjen e interesit publik, synon të forcojë mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike, duke adresuar rreziqet e ndikimit të huaj në sektorët strategjikë si energjia, transporti, mbrojtja, teknologjia e informacionit, media dhe kujdesi shëndetësor, nëpërmjet mekanizmave ligjorë, diversifikimit të burimeve të furnizimit dhe partneritetit strategjik.

Republika e Shqipërisë do të promovojë investime në teknologji të sigurta dhe të certifikuara, duke inkurajuar operatorët për modernizimin e rrjeteve dhe zëvendësimin e infrastrukturës së amortizuar apo të pasigurt.

Republika e Shqipërisë do të forcojë transparencën dhe edukimin financiar, duke rritur ndërgjegjësimin mbi rreziqet që dezinformimi paraqet për stabilitetin ekonomik dhe sigurinë kombëtare.

---

## ADRESIMI I KËRCËNIMEVE NDAJ SEKTORËVE STRATEGJIKË DHE SISTEMIT FINANCIAR TË EKONOMISË

Analizimi i rasteve të mundshme të ndërhyrjeve të huaja që mund të çojnë në destabilizimin e ekonomisë dhe sektorëve të tjerë strategjikë, përfshirë sistemin financiar, që dikton nevojën për zhvillimin e politikave për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja që mund të dëmtojnë stabilitetin ekonomik, duke përfshirë mbrojtjen e sektorëve kyç dhe garantimin e sigurisë të sistemit financiar.

Ndërhyrja hibride përdor mjete politike, diplomatike, informative, ushtarake, ekonomike, financiare, inteligjente por pa përjashtuar përdorimin e instrumenteve ligjore dhe në dukje legjitime për të arritur objektiva armiqësore dhe për të minuar interesat e Republikës së Shqipërisë. Shpejtësia, shtrirja dhe intensiteti i ndërhyrjeve hibride janë rritur, pjesërisht si rezultat i zhvillimit të teknologjisë së re.

Republika e Shqipërisë do të përdorë një sistem dhe transparent kontrolli për investimet e huaja në sektorët strategjikë të ekonomisë dhe ndërmarrjet kyçe, veçanërisht ato që janë pjesë e infrastrukturës kritike apo të tjera që kanë rëndësi të veçantë publike.

Republika e Shqipërisë, në funksion të qëndrueshmërisë ekonomike dhe zvogëlimit të ndikimeve të huaja në ekonomi, angazhohet të diversifikojë marrëdhëniet tregtare, të promovojë konkurrueshmërinë, duke synuar reduktimin e varësisë nga tregje të caktuara.

Republika e Shqipërisë angazhohet të forcojë sigurinë e infrastrukturës së telekomunikacionit, nëpërmjet një kuadri rregullator për certifikimin e furnitorëve dhe pajisjeve, në përputhje me standardet e BE-së.

Republika e Shqipërisë synon të rrisë transparencën dhe mbikëqyrjen e zinxhirit të furnizimit të pajisjeve të rrjeteve kritike, duke garantuar auditime të rregullta dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurt.

## OBJEKTIVI IV: MBROJTJA DHE FORCIMI I LIRISË SË SHPREHJES, LIRISË SË MEDIAS, SI DHE RITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE ANGAZHIMIT PUBLIK KUNDËR DEZINFORMIMIT

---

### ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAVE TË PAVARURA PËR TË LUFTUAR DEZINFORMIMIN

Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile dhe forcimi i mediave të pavarura për të identifikuar, ekspozuar dhe rritur edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi rreziqet e dezinformimit dhe manipulimit të informacionit, përfshirë krijimin e mekanizmave për monitorimin dhe analizën e përmbajtjeve të rreme dhe përhapjen e informacionit të saktë dhe të verifikuar.

Republika e Shqipërisë angazhohet të sigurojë pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile gjatë hartimit të kuadrit të ri rregullator për të adresuar ndërhyrjet e huaja, përfshirë dezinformimin, për të garantuar një balancë të drejtë mes mbrojtjes së sigurisë dhe ruajtjes së të drejtave dhe lirive themelore, si liria e shprehjes dhe e privatësisë.

Republika e Shqipërisë angazhohet në përafrimin e plotë të *Acquis* së BE-së në fushën e shërbimeve digjitale, inteligjencën artificiale dhe median<sup>12</sup>, për të siguruar një hapsirë më të sigurt dhe të drejtë digjital për qytetarët dhe bizneset.

Republika e Shqipërisë do të nxisë, mbështesë dhe promovojë krijimin e rrjetit universitar të solidaritetit kundër ndërhyrjeve të huaja, përfshirë dezinformimin, i cili do të zhvillojë metoda të reja inovative, për zbulimin e fushatave të dezinformimit, duke përdorur teknologjinë.

Republika e Shqipërisë angazhohet të mbështesë dhe inkurajojë zhvillimin e start-up-eve dhe projekteve teknologjike që përqendrohen në zgjidhje si analiza e dezinformimit, kontrolli i fakteve, dallimi i deep fake dhe siguria kibernetike.

Republika e Shqipërisë angazhohet për forcimin e kapaciteteve institucionale në nivel kombëtar për parandalimin, zbulimin dhe analizimin e dezinformimit, përmes zhvillimit të programeve të trajnimit, aftësimit të specialistëve të komunikimit dhe përmirësimit të komunikimit strategjik të entiteteve publike. Institucioni përgjegjës për komunikimin strategjik do të ketë një rol kyç në koordinimin dhe zhvillimin e këtyre kapaciteteve në të gjithë administratën publike. Në këtë proces, një bashkëpunim i ngushtë me shoqërinë civile dhe median është thelbësor për të forcuar qëndrueshmërinë demokratike dhe rritur ndërgjegjësimin publik mbi sfidat e dezinformimit.

---

<sup>12</sup> DSA (Akti për Shërbimet Digjitale), EMFA (Aktin Evropian për Lirinë e Medias), DMA (Akti për Tregun Digjitale) dhe AIA (Aktin për Inteligjencën Artificiale)

---

## MBËSHTETJA E GAZETARISË INVESTIGATIVE DHE KËRKIMIT TË PAVARUR TË FAKTEVE NË LUFTËN KUNDËR DEZINFORMIMIT

Nxitja e raportimit investigativ dhe gazetarisë së pavarur në nivel kombëtar, për të fuqizuar gazetarinë e bazuar në fakte, si një mjet thelbësor për të kundërshtuar përhapjen e informacionit të manipuluar dhe për të garantuar transparencë.

Republika e Shqipërisë angazhohet për të nxitur dhe mbështetur shoqërinë civile dhe median, duke promovuar gazetarinë profesionale, iniciativat vetërregulluese dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik për median. Një ekosistem mediatik i pavarur dhe financiarisht i qëndrueshëm është thelbësor për lirinë e shprehjes, aksesin e qytetarëve në informacion të besueshëm dhe forcimin e demokracisë. Diversifikimi i modeleve të financimit dhe transparenca financiare e mediave janë elementë kyç në garantimin e pavarësisë dhe funksionimit të tyre të pandikuar afatgjatë .

---

## PROMOVIMI I INFORMACIONIT TË BESUESHËM, RITJIA E NDËRGJEGJËSIMIT E EDUKIMIT MEDIATIK, SI DHE FUQIZIMI I AFTËSIVE DIGJITALE TË QYTETARËVE, ME QËLLIM FORCIMIN E RËZISTENCËS SHOQËRORE NDAJ DEZINFORMIMIT

Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë që promovojnë aksesin në informacion të besueshëm dhe mbrojtjen e lirisë së medias, përfshirë edukimin digjital të qytetarëve, zhvillimin e aftësive për të dalluar informacionin e rremë, për të rritur sigurinë dhe etikën në përdorimin e internetit, si dhe për të garantuar mbrojtjen e të gjitha lirive themelore.

Republika e Shqipërisë do të investohet në mënyrë të vazhdueshme në ndërgjegjësimin e shoqërisë në tërësi për ekzistencën dhe natyrën e ndërhyrjes hibride. Kundërveprimi ndaj ndërhyrjes hibride do të jetë gjithashtu pjesë e programeve edukative dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit. Në këtë drejtim, do të forcohet bashkëpunimi mes qeverisë, sektorit privat, sistemit arsimor, mediave dhe shoqërisë civile.

Republika e Shqipërisë angazhohet për përfshirjen e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI) dhe zhvillimin e aftësive digjitale, në kurrikulat e shkollave dhe universiteteve, si dhe të krijojë programe trajnimi për mësuesit dhe administratën publike, në funksion të zhvillimit të një brezi qytetarësh të informuar dhe me aftësi të mira, për të dalluar dhe përballuar dezinformimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë.

Media do të publikojë në mënyrë të dukshme politikat editoriale dhe standardet për moderimin e përmbajtjes, duke i dhënë audiencës mundësinë të kuptojë qartë proceset e përzgjedhjes së lajmeve dhe verifikimit të fakteve.

## UDHËRRËFYESI I STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR NDËRHYRJEVE TË HUAJA DHE DEZINFORMIMIT

Qëllimi i këtij udhërrëfyese është të përshkruajë hapat në vijim që duhen ndjekur për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të strategjisë përmes një procesi afatgjatë dhe gjithëpërfshirës, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.

Këshilli i Ministrave do të hartojë dhe miratojë Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, brenda vitit 2025, duke siguruar mbështetjen buxhetore të nevojshme për planin e masave dhe investimeve.

Zbatimi i Strategjisë dhe i Planveprimit do t'i nënshtrohet në vijimësi mbikëqyrjes parlamentare dhe duhet të jetë i harmonizuar rregullisht me dokumentet kombëtare.

Sistemi i unifikuar i koordinimit ndërqeveritar do të përfshijë një autoritet rregullator dhe mbikëqyrës politikash, të pavarur (Kuvendi i RSH) dhe një institucion në nivel ekzekutiv për koordinimin operacional, përgjegjës për zbatimin e politikave/strategjisë, si dhe për hartimin e Planit të Veprimit të Strategjisë dhe harmonizimin e tij me dokumentat e tjerë strategjik.

### OBJEKTIVI I: NGRITJE DHE KONSOLIDIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR TË PARANDALUAR, ZBULUAR DHE ANALIZUAR NDËRHYRJET E HUAJA NË FUSHATAT ZGJEDHORE.

FUSHAT DHE OBJEKTIVAT	PËRSHKRIMI	AFATI KOHOR	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS
<b>Fusha 1.1: Përforcimi i mbrojtjes ligjore dhe monitorimit të procesit zgjedhor</b>			
<b>1.1.1</b> Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor	Amendimi i kuadrit ligjor zgjedhor me objekt rregullimin e financimeve nga burimet të huaja dhe të dyshimta, dhe fushatën hije.  Forcimi i rregulloreve për parandalimin e përdorimit të fondeve të paligjshme për kandidatët politikë.	12 muaj	Kuvendi i RSH KQZ MD  Partnerë Mbështetës: OSBE, ODIHR, BE

<p><b>1.1.2 Një kuadër rregullator për vlerësimin paraprak dhe auditues për sistemet TIK në proceset zgjedhore.</b></p> <p><b>Auditimi dhe certifikimi i databazave të zgjedhësve dhe pajisjeve zgjedhore.</b></p>	<p>Miratimi i akteve ligjore që parashikojnë procedura për vlerësimin paraprak dhe auditimin e sistemeve TIK të përdorura në zgjedhje.</p> <p>Këto procedura duhet të vlerësojnë sigurinë e sistemeve TIK zgjedhore, identifikimin e dobësive dhe certifikimin sipas standardeve ndërkombëtare.</p> <p>Gjithashtu, të parashikohen procedura back-up për rastet eventuale të mosfunksionimit të sistemeve.</p>	<p>12 muaj</p>	<p>KQZ MB</p> <p><u>Partnerë Mbështetës:</u> OSBE, ODIHR, BE</p>
<p><b>1.1.3 Hartimi i një plani emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike.</b></p>	<p>Zhvillimi i protokolleve reaguese, procedurave emergjente, simulimeve dhe testeve periodike për sulme kibernetike gjatë periudhës zgjedhore.</p>	<p>9 muaj</p>	<p>KQZ MM</p>
<p><b>Fusha 2: Krijimi i transparencës dhe mbikëqyrjes së financimeve politike</b></p>			
<p><b>1.2.1 Hartimi i legjislacionit për ndalimin e financimeve të huaja.</b></p>	<p>Draftimi dhe miratimi i ligjeve që ndalojnë financimet nga burime të jashtme për partitë politike dhe fushatat zgjedhore, përfshirë sanksionet.</p>	<p>12 muaj</p>	<p>Kuvendi i RSH KQZ MD</p> <p><u>Partnerë Mbështetës:</u> ODIHR, BE</p>
<p><b>1.2.2 Krijimi i një platforme digjitale për transparencë financiare.</b></p>	<p>Vendosja e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë reale të burimeve financiare dhe shpenzimeve të partive politike, me publikim të plotë për qytetarët dhe mediat.</p>	<p>12 muaj</p>	<p>KQZ MD</p> <p><u>Partnerë Mbështetës:</u> OSBE, BE</p>

<p><b>1.2.3 Miratimi i një kuadri rregullator për veprimtarinë lobuese</b></p>	<p>Draftimi dhe miratimi i një ligji që rregullon veprimtarinë lobuese, ku të rregullohen çështjet në raport me ndërhyrjen e huaj.</p>	<p>18 muaj</p>	<p>MD KQZ <u>Partnerë Mbështetës:</u> OSBE, ODIHR</p>
<p><b>1.2.4 Ngritja e një regjistri kombëtar për transparencën e aktiviteteve të lobimit.</b></p>	<p>Krijimi i një database publike që regjistron aktivitetet e lobimit dhe burimet financiare të lidhura.</p>	<p>18 muaj</p>	<p>MD KQZ <u>Partnerë Mbështetës:</u> OSBE, ODIHR</p>
<p><b>1.2.5 Fuqizimi i mbikëqyrjes financiare</b></p>	<p>Përmirësimi i kapaciteteve teknologjike të KQZ-së dhe ngritja e një autoriteti të pavarur për monitorimin e shpenzimeve politike.</p>	<p>Në vijimësi (integrim me 1.2.1 dhe 1.2.2)</p>	<p>KQZ Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen e financimeve të partive <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE</p>
<p><b>1.2.6 Organizimi i trajnimeve dhe projekteve ndërkombëtare për përmirësimin e mbrojtjes zgjedhore</b></p>	<p>Angazhimi në programe ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe ndarja e përvojave në fushën e sigurisë zgjedhore.</p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>MEPJ AKSHI KQZ <u>Partnerë Mbështetës:</u> NATO, BE, OSBE</p>
<p><b>1.2.7 Rregullimi i aktivitetit të palëve të treta në fushatat zgjedhore</b></p>	<p>Vendosja e rregullave për regjistrimin dhe deklarimin e burimeve financiare dhe lidhjeve të palëve të treta; krijimi i një database publike dhe sanksionimi i shkeljeve.</p>	<p>12 muaj</p>	<p>KQZ <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE</p>

<b>Fusha 3: Forcimi i përgjegjësisë dhe koordinimit ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë</b>			
<b>1.3.1</b> Krijimi i një njësie të dedikuar për monitorimin e dezinformimit digjital	Vendosja e një njësie brenda KQZ-së për monitorimin e përmbajtjeve online dhe reagimin në kohë reale ndaj fushatave manipuluese	Fillimisht: 6 muaj, Në vijimësi	KQZ <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE
<b>1.3.2</b> Rregullimi i rrjeteve sociale dhe reklamave politike online	Vendosja e kriterëve të qarta për transparencë, duke përfshirë deklarimin e sponsorëve dhe burimeve financiare; krijimi i një platforme kombëtare për monitorimin e përmbajtjeve	6-12 muaj	KQZ AMA <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE
<b>1.3.3</b> Koordinimi ndër-kombëtar për ndarjen e inteligjencës mbi kërcënimet hibride	Organizimi i mekanizmave të ndarjes së informacionit dhe bashkëpunimit me NATO-n dhe BE-në për adresimin e kërcënimeve hibride.	Në vijimësi	MEPJ MM AKSHI AKSK  <u>Partnerë Mbështetës:</u> NATO, BE, Hybrid CoE
<b>1.3.4</b> Ndërveprimi me struktura ndërkombëtare dhe qendra ekspertize për ndërhyrjen	Vendosja e partneritetit me struktura ligjzbatuese dhe kërkimore në rajon dhe Evropë me objekt parandalimin e ndërhyrjeve të huaja.	6 muaj, Në vijimësi	MEPJ MM KQZ  <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE

<b>Fusha 4: Kriminlizimi i ndërhyrjeve të huaja dhe forcimi i kuadrit ligjor</b>			
<b>1.4.1</b> Draftimi dhe miratimi i ligjeve për ndëshkimin e financimeve të paligjshme dhe ndërhyrjeve hibride	Hartimi i ligjeve që kriminalizojnë ndërhyrjet e jashtme dhe financimet e paligjshme, sipas standardeve ndërkombëtare.	12 muaj	MD KQZ Kuvendi i RSH  <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, ODIHR
<b>1.4.2</b> Përmirësimi i rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale	Modernizimi i normave për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e sigurisë zgjedhore.	6 muaj	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE
<b>Fusha 5: Ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimi publik</b>			
<b>1.5.1</b> Organizimi i trajnimeve për zyrtarët zgjedhorë	Hartimi dhe implementimi i moduleve trajnimi sipas standardeve ndërkombëtare, me seminare dhe trajnime praktike.	6–12 muaj	KQZ Akademia e Sigurisë  <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE
<b>1.5.2</b> Fushata ndërgjegjëse për qytetarët	Zhvillimi i fushatave informative në media tradicionale dhe digjitale, organizimi i eventeve publike dhe debatet për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndikimin e ndërhyrjeve të huaja	Në vijimësi	KQZ AMSHC SASPAC Organizata të Shoqërisë Civile  <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE

1.5.3 Fushata ndërgjegjësimit me institucionet e arsimit të lartë	Zhvillimi i veprimtarive akademike dhe studentore me objekt ndërhyrjet e huaja.	Në vijimësi	Ministria e Arsimit, Universitetet  <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, OSBE
<b>OBJEKTIVI II: MBROJTJA E SIGURISË KOMBËTARE NGA NDËRHYRJET E HUAJA DHE DEZINFORMIMI</b>			
<b>Fusha 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim.</b>			
2.1.1 Hartimi i një akti ligjor mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin.	Të ndermerret hartimi dhe miratimi i një akti ligjor që parashikojë fushë veprimtari, përkufizime, rregullim ligjor dhe institucionet përgjegjëse për çështjet e ndërhyrjeve dhe dezinformimin.	Shtator - Dhjetor 2025	Këshilli i Ministrave Kuvendi i RSH
2.1.2 Krijimi i një strukture të veçantë për evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim. (Në vijim referuar si “Struktura Përgjegjëse”.)	Të parashikohet ngritja e një organi për monitorimin e ndikimeve hibride dhe luftimin e fushatave dezinformuese. Kjo strukturë të përfshijë ekspertë të lartë dhe të specializuar, dhe t’i mundësohen instrumenta ligjorë dhe kapacitete teknologjike në funksion të detyrave.	Shtator - Dhjetor 2025	Këshilli i Ministrave Kuvendi i RSH
2.1.3 Kooridinimi ndërinstitucional dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim.	Ngritja e rrjetit të komunikimit, krijimi i praktikave të mirave të bashkëpunimit dhe i shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Caktimi i personave përgjegjës në institucionet përgjegjëse si persona	Brenda Mars 2026 Në vijimësi	Struktura Përgjegjëse AKSHI AKSK KQZ

	kontakti dhe parashikimi i trajnimeve për rritjen e ekspertizës.			
<b>2.1.4 Komisioni i Përhershëm Parlamentar, për ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin</b>	Të rriten burimet dhe ekspertiza parlamentare nëpërmjet koordinimit me institucionet shtetërore, akademike, shoqërimë civile, median dhe sektorin privat, si dhe të organizohen seanca dëgjimore publike e raportime periodike, me qëllim garantimin e një mbikëqyrjeje efektive, transparente dhe të përgjegjshme ndaj çdo lloj forme të FIMI-t.	Brenda Tetor 2025, Në vijimësi	Kuvendi i RSH	
<b>2.1.5 Raportimi periodik në Komision Parlamentar nga struktura që do të krijohet për zbulimin, analizimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse dhe dezinformimit.</b>		Periodikisht (së paku çdo katër muaj ose me kërkesë).	Struktura Përgjegjëse	
<b>2.1.6 Ngritja e rrjetit të komunikimit me operatorët mediatikë (online dhe social) dhe bashkëpunimi me subjektet e angazhuar në verifikimin e vertetësisë së informacionit.</b>		Në vijimësi	Struktura Përgjegjëse	
<b>2.1.7 Formimi i një bashkëpunimi për të promovuar bashkërrregullimin dhe vetërregullimin në fushën e medias.</b>		Në vijimësi	Struktura Përgjegjëse	

<b>Fusha 2: Ndërgjegjësimi publik mbi instrumentat e ndërhyrjeve dhe rritja e edukimit publik mbi dezinformimin.</b>			
<b>2.2.1 Hartimi i një strategjie kombëtare për edukimin mediatic dhe/ose integrimi i edukimit mediatic në arsimin e përgjithshëm.</b>		Brenda vitit 2026.	Struktura Përgjegjëse
<b>2.2.2 Hartimi i udhëzuesve / materialeve të informimit të gjerë publik mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin.</b>	Të synohet përgatitja e teksteve dhe materialeve për një kuptim më të mirë të burimeve të dezinformimit dhe të synimeve, mjeteve dhe objektivave që qëndrojnë pas dezinformimit, por edhe të cënueshmërive/dobësive tona.	Në vijimësi	Struktura Përgjegjëse
<b>2.2.3 Veprimtari me qëllim edukimin publik mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin.</b>	Ndërtimi i qëndrueshmërisë përfshin gjithashtu trajnime të specializuara, konferenca publike dhe debate, si dhe forma të tjera të të mësuarit të përbashkët për mediat. Ai gjithashtu përfshin fuqizimin e të gjithë sektorëve të shoqërisë dhe, në veçanti, përmirësimin e edukimit mediatic të qytetarëve për të kuptuar se si të dallojnë dhe të shmangin dezinformimin.	Në vijimësi	Struktura Përgjegjëse
<b>OBJEKTIVI III: PER MBROJTJEN E EKONOMISË KOMBËTARE DHE SEKTORËVE TË TJERË KRITIK</b>			
<b>Fusha 1: Forcimi i mekanizmave ligjzbatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonominë vendase</b>			
<b>3.1.1 Miratimi i ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja</b>	Shqipërisë i nevojitet një ligj i ri që parashikon një Mekanizëm për Shqyrtimin e Investimeve (MSHI) dhe që përfshin përkufizime të qarta të:	Brenda 2026	Këshilli i Ministrave Kuvendi i RSH Struktura Përgjegjëse

	<p>a) sigurisë kombëtare; b) infrastrukturës kritike (energjetika, transporti, uji, shëndetësia, komunikimet, media, përpunimi ose ruajtja e të dhënave, infrastruktura zgjedhore ose financiare, si dhe strukturat delikate dhe investimet në blerje të tokave dhe pasurisë të paluajtshme që janë thelbësore për përdorimin e infrastrukturave në fjalë); c) teknologjitë kritike dhe objektet me përdorim të dyfishtë (duke përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën, gjysmëpërcjellësit, sigurinë kibernetike, kuantumin, hapësirën ajrore, mbrojtjen, ruajtjen e energjisë dhe teknologjitë bërthamore, nanoteknologjitë dhe bioteknologjitë); d) aksesin ose aftësinë për të kontrolluar informacionet delikate (përfshirë të dhënat personale) dhe; e) lirinë dhe pluralizmin e medias.</p>		
<p><b>3.1.2 Zbatimi i një sistemi transparent për monitorimin e investimeve në sektorët strategjikë</b></p>	<p>Gjatë hartimit të legjislatimit për MSHI-në, të ruhet balanca ndërmjet ndikimit të ekzekutivit duke përfshirë autoritetin e grupeve të interesit, si komuniteti i biznesit, në procesin e vendimmarrjes</p>	<p>Në vijimësi</p>	
<p><b>3.1.3 Monitorim dhe kufizimi i varësisë nga furnitorë të pasigurt.</b></p>		<p>Në vijimësi</p>	<p>Kuvendi RSH (Komisioni i Përhershëm) Struktura Përgjegjëse APP AKSHI</p>

<p>3.1.4 Krijimi i një njësie të specializuar në nivel kombëtar për monitorimin e informacionit të rremë në sektorë kritike/sistemin bankar dhe financiar.</p>		<p>Në vijimësi</p>	<p>Banka e Shqipërisë Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar Struktura Përgjegjëse</p>
<p><b>Fusha 2: Rritja e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit bankar në parandalimin e problematikave dhe informimi publik</b></p>			
<p>3.2.1 Forcimi i ndërveprimit dhe komunikimit të sektorit privat me institucionet publike.</p>	<p>Zhvillimi i një forumi me pjesëmarrjen e aktorëve publikë dhe privatë për analizimin e dinamikave të tregut në raport me vulnerabilitet e ekonomisë vendase në raport me aktorët e huaj.</p>	<p>Periodik (12 muaj)</p>	<p>Struktura Përgjegjëse Ministri përgjegjës për Sipërmarrjen Këshilli Ekonomik Kombëtar, Dhoma Kombëtare e Ekonomisë Organizata përfaqësuese të operatorëve ekonomik</p>
<p>3.2.2 Informimi publik mbi gjendjen e ekonomisë vendase në raport me kapitalin dhe investimet e huaja.</p>	<p>Përgatitja mbi indikatorë dhe metodologji, si dhe publikimi i raportimeve periodike që të garantojnë informacion të plotë dhe sintetik mbi gjendjen e ekonomisë shqiptare në raport me kapitalin dhe investimet e huaja, investimet e huaja, operatorët e rinj ndërkombëtarë dhe panoramë të flukseve financiare.</p>	<p>Periodik (6 muaj)</p>	<p>Struktura Përgjegjëse Ministria përgjegjëse për financat, Banka e Shqipërisë Ministria përgjegjëse për ekonominë</p>
<p><b>OBJEKTIVI IV: MBROJTJA DHE FORCIMI I LIRISË SË SHPREHJES, LIRISË SË MEDIAS, SI DHE RRIJTJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE ANGAZHIMIT PUBLIK KUNDËR DEZINFORMIMIT</b></p>			
<p><b>Fusha 1: Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin.</b></p>			

<p><b>4.1.1 Krijimi i mekanizmave të strukturuar bashkëpunimi midis institucioneve që trajtojnë FIMI-në dhe OJF-ve, duke mundësuar analizimin dhe monitorimin e ndërhyrjes së huaj.</b></p>		12 muaj	<p>Kuvendi i RSH</p> <p><u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, Hybrid CoE, OSBE.</p>
<p><b>4.1.2 Mbështetja me fonde publike e programeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për OJF-të për të zhvilluar ekspertizë në kërkimin, analizën dhe zbulimin e FIMI-së, si edhe në advokim, rritje ndërgjegjësimit</b></p>		Në vijimësi	<p>Këshilli i Ministrave Kuvendi i RSH AMSHC AMA</p> <p><u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, Hybrid CoE, OSBE.</p>
<p><b>4.1.3 Promovimi i gazetarisë të verifikimit të fakteve në transmetimet e medias publike (RTSH) dhe mediat kombëtare</b></p>		Në vijimësi	<p>AMA RTSH Kuvendi i RSH</p>
<p><b>4.1.4 Zhvillimi i programeve trajnuese dhe mekanizma mbështetës për gazetarët / mediat / mbikqyrësit publik mbi sigurinë digjitale (p.sh. enkriptimi i komunikimit, përdorimi i VPN-ve) dhe praktikat kundër sulmeve kibernetike ose spyware, në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.</b></p>		12 muaj	<p>AKSK</p> <p>Departamenti i Gazetarisë, pranë Universitetit të Tiranës.</p>

<p>4.1.5 Mundësi i lehtësirave fiskale për Gazetarinë Investigative për të forcuar pluralizmin mediatik dhe për të luftuar dezinformimin e mbështetur nga aktorë të huaj.</p>		24 muaj	Ministria përgjegjëse për financat
<p><b>Fusha 2: Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si dhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit</b></p>			
<p>4.2.1 Publikimi në mënyrë të dukshme i politikave editoriale dhe standardet për moderimin e përmbajtjes në media, duke i dhënë audiencës mundësinë të kuptojë qartë proceset e përzgjedhjes së lajmeve dhe verifikimit të fakteve.</p>		12 muaj	AMA
<p>4.2.2 Përfshirja e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI), së bashku me aftësitë digjitale, në kurrikulat e shkollave parauniversitare dhe universitare.</p>	<p>Të synohet përgatitja e teksteve dhe materialeve për një kuptim më të mirë të burimeve të dezinformimit dhe të synimeve, mjeteve dhe objektivave që qëndrojnë pas dezinformimit, por edhe të cënueshmërive/dobësive tona.</p>	24 muaj	<p>Struktura Përgjegjëse Këshilli i Ministrave <u>Partnerë Mbështetës:</u> BE, Hybrid CoE</p>
<p>4.2.3 Zbatimi i fushatave të gjera ndërgjegjëse për publikun, të përqendruara në identifikimin e taktikave të dezinformimit dhe nxitjen e mendimit kritik te qytetarët, për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj FIMI-t.</p>	<p>Ndërtimi i qëndrueshmërisë përfshin trajnime të specializuara, konferenca publike dhe debate, si dhe forma të tjera të të mësuarit të përbashkët për mediat. Ai gjithashtu përfshin fuqizimin e të gjithë sektorëve të shoqërisë dhe, në veçanti, përmirësimin e edukimit mediatik të qytetarëve për të kuptuar se si të dallojnë dhe të shmangin dezinformimin.</p>	Në vijimësi	Struktura Përgjegjëse

<p><b>4.2.4 Krijimi i moduleve të detyrueshme të trajnimit mbi EMI dhe sigurinë digjitale në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).</b></p>		<p>24 muaj Në vijimësi</p>	<p>Struktura Përgjegjëse ASPA</p>
--	--	--------------------------------	---------------------------------------